



Shenjt-Naumi


Francobolino

www.delcampe.net

Si e shiti Zogu Shën Naumin

Pregatitur nga ShtetiWeb

Shën Naumi tokë
shqiptare, Zogu e
dhuroi



Shën Naumi tokë shqiptare, Zogu e dhuroi

Shën Naumi dhe Vermoshi janë emrat e dy territoreve, të cilat Ahmet Zogu ia dhuroi Jugosllavisë në vitin 1925 (dhuratë e cila u legalizua në vitin 1926) si shpërblim për ndihmën politike, financiare dhe ushtarake që atij i dha kryeministri serb Nikolla Pashiçi për të shtypur në dhjetor 1924 qeverinë revolucionare të Fan Nolit dhe për të rivendosur autoritetin e vet pushtetor në Shqipëri.

Ky ndryshim i padrejtë i kufirit shqiptaro-jugosllav në dëm të Shqipërisë, është kritikuar vazhdimisht gjatë këtyre tetë dekadave të fundit që kur ajo u nënshkrua, madje vazhdon të kritikohet edhe në ditët tona. Megjithatë, një histori e plotë dhe e dokumentuar për këtë ngjarje kaq të debatuar, për shkak të fondit jo të plotë të burimeve historike, ende nuk njihet nga publiku shqiptar dhe ndërkombëtar në thellësinë dhe në gjerësinë e saj. Botimi i vëllimit dokumentar me materialet e Arkivit Qendror të Shtetit, përgatitur nga Prof. Kaliopi Naska, me titull "Shën Naumi dhe diplomacia e kohës" (shtëpia botuese "Kristalina - K.H.", Tiranë 2012), krijoi mundësinë për një ritrajtim më të thelluar dhe më të dokumentuar të këtij problemi herë pas here të debatuar. Paraprakisht pohojmë se kritikën e vazhdueshme që e dënonin Ahmet Zogun për cenimin e integritetit territorial të atdheut tani vërtetohen katërcipërisht. Madje, tani del e qartë se përgjegjës nuk qe vetëm A. Zogu, në atë kohë President i Republikës së Shqipërisë, por edhe Asambleja Legjislative, e përbërë në atë kohë nga Parlamenti dhe nga Senati. Kjo për arsye se deputetët dhe senatorët e shkelën dinjitetin e tyre politik dhe patriotik dhe ndoshta pa qenë të ndërgjegjshëm, u bënë bashkëpunëtorë dhe bashkëfajtorë me Ahmet Zogun.

Parahistoria e çështjes

Parahistoria e çështjes së Manastirit të Shën Naumit dhe të Velipojës së Vermoshit fillon në vitin 1913. Konferenca e Ambasadorëve të gjashtë Fuqive të Mëdha (Britania e Madhe, Franca, Rusia, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia) në Londër, nën kryesinë e ministrit të Jashtëm britanik Eduard Grey-it, pasi miratoi më 29 korrik 1913 statusin politik të Shqipërisë si një principatë e pavarur nën garancinë dhe nën kontrollin e gjashtë Fuqive të Mëdha, mori përsipër të caktonte ajo vetë pa pyetur popullsinë vendëse dhe pa u këshilluar me statistikat demografike të kohës, kufijtë e shtetit të ri shqiptar. Më 1913 Mali i Zi ishte mbretëri më vete, me kryeqytet Cetinën, e shkëputur nga mbretëria e Serbisë, me kryeqytet Beogradin. Si rrjedhim, Vermoshi, cepi më verior i Kelmendit, bënte pjesë në kufirin shqiptaro-malazez, kurse Manastiri i Shën Naumit tani me disfatën e Perandorisë Osmane, në kufirin shqiptaro-serb.

Me protokollin që konferenca nënshkroi më 11 gusht 1913 u caktua në parim vija e kufirit shqiptaro-malazez dhe shqiptaro-serb. Në kufirin shqiptaro-malazez në sektorin e Vermoshit nuk u bë ndryshim, por u miratua



vija e kufirit që ekzistonte më parë midis Malit të Zi dhe Turqisë.

Brenda kufirit të shtetit shqiptar u përfshi ashtu siç ishte dhe më parë, gjithë treva e fshatit Vermosh. Pikë referimi e këtij kufiri ishte karakolli turk (postu i rojës kufitare) që kishte ndërtuar administrata osmane. Në kufirin shqiptaro-serb në mungesë të një kufiri të mëparshëm, Fuqitë e Mëdha u detyruan të caktonin një kufi të ri. Kufiri i ri u caktua në parim në protokollin e nënshkruar prej tyre më 11 gusht 1913. Në nenin 2 të këtij protokollit thuhej tekstualisht: "Që tani është e vendosur... që kazaja e vjetër osmane e Korçës me bregun perëndimor dhe jugor të liqenit të Ohrit, që shtrihet që nga fshati Lin deri në Manastirin e Shën Naumit, janë pjesë përbërëse e Shqipërisë". (A. Puto. Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare. Vëll. II. 1912-1918, Tiranë, 1987, f. 287. Shih gjithashtu: A. Puto. Idem. Vëll.III Tiranë 2001, f. 78). Kjo do të thotë se Shën Naumi ashtu si krejt fshati Vermosh me bjeshkët dhe kullotat e tij qenë përfshirë brenda kufirit të Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha që më 1913. Pra, gjithë territoret që bënin pjesë në kazanë turke të Korçës do të përfshiheshin brenda kufijve të Shqipërisë, kurse në liqenin e Ohrit kufiri i ri shqiptaro-serb do të ndiqte pjesën perëndimore të ujërave të liqenit të Ohrit që nga fshati Lin deri në Manastirin e Shën Naumit. Cetina kërkoi rishikimin e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve për çështje kullotash në Velipojën e Vermoshit, e cila sipas saj u kishte shërbyer banorëve malazezë të fshatrave fqinje. Përkundrazi, qeveria e Beogradit përveç argumentit fetar se gjoja

Manastiri i Shën Naumit ishte një vend i shenjtë serb, ajo e interpretoi përmbajtjen e nenit nr. 2 në favor të Serbisë. Sipas saj, parafjala "deri" në Manastirin e Shën Naumit do të thoshte se Manastiri i Shën Naumit mbetej jashtë kufirit të Shqipërisë, pra brenda kufirit të Serbisë. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore interpretimi i saktë i nenit 2 të Protokollit mbeti pa u sqaruar. Në bazë interpretimit të saj, ajo vazhdoi ta mbante të okupuar me ushtritë e saj manastirin, gjoja se i përkiste Serbisë.

Pas luftës kur Mali i Zi u përfshi në Mbretërinë e Jugosllavisë, e cila në fillim u quajt "Mbretëria serbo-kroato-slllovene", çështjen e rishikimit të kufirit në të dy këta sektorë e ndoqi qeveria jugosllave me qendër në Beograd. Madje, së bashku me rishikimin e kufirit në sektorin e manastirit të Shën Naumit qeveria jugosllave ngriti edhe rishikimin e kufirit në sektorin malazez. Argumentet që qeveria jugosllave sillte për aneksimin e Manastirit të Shën Naumit kishin si dhe më parë karakter fetar. Sipas saj, Manastiri ishte një vend i shenjtë për serbët dhe për këtë arsye, i takonte Serbisë. Në të vërtetë, Manastiri i Shën Naumit nuk kishte karakter fetar serb, por shqiptaro-maqedon. Ai ishte ndërtuar në shekullin IX në kohën e Perandorisë Bullgare nga predikatori sllav Naumi, i cili kishte vepruar për mjaft kohë në Shqipërinë e Jugut. Kisha e ndërtuar brenda Manastirit i kushtohet kryeengjellit Mëhill. Kisha e sotme është rindërtuar në shekullin XVI mbi themelet e kishës së vjetër nga

Lugina e Vermoshit



popullsia e krishterë maqedone dhe shqiptare që banon në afërsi të saj. Muret e kishës kanë qenë pajisur me afreske të pikturuara nga piktori Nikolla, biri i Onufrit të

madh nga Elbasani. Në ikonostasin e punuar në dru ka edhe ikona të punuara nga piktori shqiptar i shekullit XVII-XVIII Kostandin Jeromonaku. Në muret e kishës ka gjithashtu afreske të punuara nga piktori korçar Tërpo, i biri i Athanas Zografit, gjithashtu piktor me emër. Midis pjesëtarëve të Manastirit të Shën Naumit ka patur jo vetëm murgj (kallogjerë), por edhe igumenë (drejtues) me kombësi shqiptare. Veç kësaj, në Manastirin e Shën Naumit kryenin pelegrinazh ditën e Shën Mërisë së Gushtit jo vetëm vizitorë maqedonë, por edhe shqiptarë nga rrethet e Shqipërisë Juglindore.

Në lidhje me Vermoshin, Jugosllavia nuk kishte argumente etnikë apo historikë. Kjo për arsye se Vermoshi me pyje prej ahu dhe pishë, me kullota të pasura për shtegtime verore, me banorë krejtësisht shqiptarë katolikë dhe pjesë e pandarë e krahinës së

Kelmendit, nuk përmbante asnjë argument që të justifikohet aneksimi i saj nga Jugosllavia, përveç sulmeve që ndërmerre ndonjë nga fiset malazeze për të siguruar për vete kullotat dhe për të rrëmbyer bagëti.

Përmes luginës së Vermoshit, i cili ndodhet në ekstremin verior të Malësisë së Kelmendit, kalon lumi Cem. Përtej lumit Cem shtrihen kullotat e Vermoshit. Për shekuj në këto kullota shtegtonin gjatë verës bagëtitë e dy bajrakeve të Kelmendit - të Vuklit dhe të Nikçit. Këto kullota, të cilat njihen nga vendësit me emrin Velipojë (Fusha e Zanave) me legjenda të pasura të mitologjisë shqiptare, i lakmonin vazhdimisht fiset fqinje malazeze. Me këtë rast kujtojmë se malësorët e Vuklit, të cilët gjatë dimrit shtegtonin për vërrin në kullotat pranë derdhjes së lumit Bunë, ia vunë vendit ku ngritën banesat e tyre në këto kullota emrin Velipojë, në kujtim të Velipojës së Vermoshit. Inkursionet e fiseve malazeze, të cilët i lakmonin këto kullota, qenë prapsur vazhdimisht nga malësorët e Vermoshit, duke lënë edhe të vrarë në këtë pllajë. Sipas "Kanunit të Maleve", këto varre kishin shërbyer si piramida kufiri. Për të penguar inkursionet e malazezëve në luginën e Vermoshit, administrata osmane kishte ndërtuar edhe një postë kufitare (karakoll) si dëshmi se pllaja dhe pylli i takonin Vermoshit.

Vendimi i Fuqive të Mëdha për të dy këto sektorë nuk linte vend për diskutim, as për rishikim.

Çështja e Shën Naumit dhe e Vermoshit në arenën diplomatike



Konferenca e Ambasadoreve

Çështja se kujt i përkiste Manastiri i Shën Naumit u përfshi me kërkesën e Jugosllavisë në arenën diplomatike më 9 nëntor 1921 - pikërisht atëherë kur nga pikëpamja juridike çështja ishte mbyllur, pasi atë ditë (9 nëntor 1921), Konferenca e Ambasadorëve miratoi vendimin me

të cilin njihej përfundimisht Pavarësia e Shqipërisë, së bashku me kufijtë e saj politikë të vendosur në parim më 1913. Komisioni i ngarkuar nga Konferenca e Ambasadorëve për të shqyrtuar pretendimin jugosllav mbi kuptimin juridik të pikës së dytë të Protokollit të përmendur, në mbledhjen që zhvilloi në gusht 1922 nuk arriti në unison. Përfaqësuesi britanik u shpreh në favor të tezës së Beogradit, kurse dy të tjerët, përfaqësuesi frëng dhe ai italian mbështetën tezën e Tiranës se parafjala "deri në" nënkuptonte përfshirjen e Manastirit brenda kufirit të Shqipërisë. Në përfundim të këtyre debateve, Konferenca e Ambasadorëve vendosi më 6 dhjetor 1922 me anë të një rezolute të posaçme që Shën Naumi i takonte Shqipërisë. Gjithashtu mendoi se kjo ishte fjala e fundit, pasi Konferenca e Ambasadorëve kishte statusin e një areopagu ndërkombëtar. Megjithatë, qeveria jugosllave e kundërshtoi edhe vendimin e 6 dhjetorit 1922. Duke parë se Konferenca e Ambasadorëve nuk i merrte në konsideratë kërkesat e saj, qeveria jugosllave hodhi idenë e rregullimit të këtyre dy çështjeve (çështjen e Manastirit të Shën Naumit dhe atë të Vermoshit) me anë shkëmbimesh territoriale. Këtë ide Konferenca e Ambasadorëve ia përcolli qeverisë shqiptare. Qeveria shqiptare e kryesuar nga Ahmet Zogu në parim nuk e kundërshtoi idenë. Më 21 shkurt 1923 ministri i Punëve të Jashtme, Pandeli Evangjeli u përgjigj se qeveria shqiptare ishte e gatshme ta pranonte propozimin "me kusht që Jugosllavia t'i lëshonte

Shqipërisë rrafshet e Sanishtës të Dibrës dhe të Rrafshit të Hasit në drejtimin e Prizrenit". Përgjigjja e Tiranës nuk i pëlqeu Beogradit. Ajo iu drejtua përsëri në prill 1923 Konferencës së Ambasadorëve me një tjetër argument. Ajo kërkoi anulimin e vendimit të 6 dhjetorit 1922 dhe zëvendësimin e tij me një vendim të ri në favor të Jugosllavisë, me argumentin e vjetër se Manastiri ishte një vend i shenjtë kombëtar për serbët. Në të njëjtën kohë, qeveria shqiptare i lutej Konferencës së Ambasadorëve që të mbante në fuqi vendimin që ajo vetë kishte marrë me të drejtë më 6 dhjetor 1922 në favor të Shqipërisë. Qeveria jugosllave nguli përsëri këmbë për anulimin e vendimit të 6 dhjetorit 1922 dhe zëvendësimin e tij me një vendim të ri në favor të Jugosllavisë. Nën presionin e kërkesave jugosllave Konferenca e Ambasadorëve ia ngarkoi edhe një herë çështjen një komisioni prej tre përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha - Angli, Francë, Itali. Këtë radhë përfaqësuesi anglez së bashku me përfaqësuesin italian mbrojtën kërkesën shqiptare, kurse përfaqësuesi i Francës pretendimin jugosllav. Meqenëse në këtë vendim kërkohet një unanimitet, Konferenca e Ambasadorëve ngarkoi një grup ekspertësh juristë të çështjeve ndërkombëtare për të interpretuar pikën 2 të përmendur të Protokollit të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, mbajtur më 11 gusht 1913. Por as grupi i ekspertëve juristë nuk arriti të jepte një vendim të prerë. (A. Puto. Po aty. Vëll. III, fq. 78-80).

Këmbëngulja e vazhdueshme e qeverisë jugosllave për të cënuar integritetin tokësor të Shqipërisë shkaktoi një zemëratë në opinionin publik shqiptar. Qytetarët korçarë, të cilët e konsideronin prej shekujsh Manastirin e Shën Naumit si një institucion të shenjtë shqiptar, zhvilluan më 12 mars 1924 një miting madhështor në qytetin e tyre. Në këtë manifestim, ku thuhet se morën pjesë rreth 12 mijë vetë, protestohet kundër rifillimit të bisedimeve mbi ndryshimin e kufirit të Shën Naumit dhe të Vermoshit, kufij të cilët, sipas tyre, ishin vendosur përfundimisht nga Konferenca e Ambasadorëve, "nga Areopagu më i lartë i botës", siç thuhej në rezolutën e tyre. Pjesëmarrësit e mitingut deklaruan se "kurrë ndonjëherë nuk do të pranojnë as ndonjë cenim të tokës shqiptare, në një kohë kur në kurriz të kombit shqiptar janë bërë shumë sakrifica në caktimin e kufijve të Shqipërisë". Mitingu miratoi me këtë përmbajtje një rezolutë, e cila iu drejtua Konferencës së Ambasadorëve. Një javë më vonë, një miting i tillë u zhvillua edhe në Vlorë. Edhe nga ky miting iu drejtua Konferencës së Ambasadorëve një rezolutë me të cilën protestohet kundër idesë për rishikimin e kufijve në territorin e Shën Naumit dhe të Vermoshit. Mitingje të tilla u zhvilluan edhe në qytete të tjera si në Tiranë, Shkodër dhe gjetkë, ku morën pjesë edhe disa deputetë të Parlamentit shqiptar. Me një memorandum që Britania e Madhe ia drejtoi Konferencës së Ambasadorëve më 4 prill 1924, ajo kërkoi që çështja e Manastirit të Shën Naumit të mbyllej

mbasi vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të 6 dhjetorit 1922 ishte marrë në bazë të rezolutës së Asamblesë të Lidhjes së Kombeve të 2 tetorit 1921, kështu që ai duhej konsideruar përfundimtar.



Gjeneral Tellini

Ndërkohë, një zhvillim më vete pati edhe kërkesa e qeverisë jugosllave për të aneksuar një pjesë të trevës së Vermoshit, të cilën ajo gjithashtu vazhdonte ta mbante të pushtuar që nga fundi i vitit 1912.

Më 17 korrik 1922 komisioni kufitar i kryesuar nga gjenerali italian Tellini, pasi dëgjo i malësorët e Vermoshit dhe dëshmitë e palës malazeze, e hodhi poshtë kërkesën e

Beogradit, duke ripohuar përfshirjen e krejt zonës së Vermoshit brenda kufijve të Shqipërisë. Jugosllavia vazhdoi të ngulte këmbë në kërkesën e saj. Përkundrazi, Konferenca e Ambasadorëve e miratoi më 11 tetor 1922 vendimin e Komisionit Tellini.

Çështja e Shën Naumit dhe e Vermoshit gjatë qeverisë së Nolit (1924)



Qeveria e kryesuar nga Fan Noli, e cila erdhi në fuqi më 17 janar 1924 fill pas fitores së Revolucionit të Qershorit, gjeti të pazgjidhur dy çështje kufitare me dy fqinjët e Shqipërisë - me Jugosllavinë kufirin në sektorin e Manastirit të Shën Naumit dhe atë të Velipojës së Vermoshit, kurse me Greqinë problemin e

14 fshatrave në sektorin lindor të rrethit të Bilishtit të cilat mbaheshin ende të pushtuara nga ushtria greke. Prej tyre, më këmbëngulëse në kërkesat e saj vazhdonte të tregojë qeveria jugosllave. Në fakt, sikurse u pa, të gjitha përpjekjet diplomatike që kishte ndërmarrë qeveria e Beogradit për të ndryshuar vendimet, të cilat i kishin dhënë të drejtë Shqipërisë, kishin dështuar. Kur qeveria e Nolit erdhi në fuqi, Britania e Madhe kishte propozuar, sikurse u tha, që çështja e Shën Naumit të konsiderohej e përfunduar në bazë të vendimit që kishte marrë Konferenca e Ambasadorëve më 6 tetor 1922.

Këtë propozim të Londrës Konferenca e Ambasadorëve ia përcolli Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Më 17 qershor 1924 (kur A. Zogu ishte emigrant në Jugosllavi), Këshilli i Lidhjes së Kombeve para se t'ia përcillte Tiranës e Beogradit vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, meqenëse u bind se çështja kishte thjesht karakter juridik, i kërkoi Dhomës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare në Hagë (Holandë) një mendim konsultativ në lidhje me pretendimet e të dyja palëve për çështjen e Manastirit të Shën Naumit. Qeveria e Beogradit e paraqiti përkujtesën e saj në Gjykatë më 14 korrik 1924. Ajo është më tepër një deklaratë e thjeshtë sesa një argumentim juridik. Meqenëse qeveria e Beogradit, thuhej në deklaratën e saj, Manastirin e Shën Naumit e ka patur nën administrim pa ndërprerje që nga viti 1913, ky fakt, pretendonte ajo, i jepte të drejtë Jugosllavisë ta zotëronte atë edhe në të ardhmen. Si rrjedhim, shtonte ajo, t'ia mohosh Jugosllavisë pas kaq vitesh Manastirin e Shën Naumit, ishte një ndëshkim për një shtet që kishte luftuar përkrah Antantës.

Parashtesa e qeverisë së Beogradit mbështetej mbi argumente të njohura e të konsumuara më parë nga Konferenca e

Ambasadorëve. Sidoqoftë, ajo e mbyllte memorandumun me një ultimatum, se pala jugosllave do të njihte vetëm zgjidhjen që do të merrej në favor të saj. Argumentet që parashtroi qeveria shqiptare e kryesuar nga Fan Noli, qenë më bindëse. Sipas saj, një çështje e vendosur mund të rishikohej nëse dilnin në shesh argumente të reja të panjohura më parë. Si rrjedhim, mbi bazë të këtij kriteri juridik, Konferenca e Ambasadorëve nuk kishte të drejtë ta rishikonte vendimin që ajo kishte marrë më 6 dhjetor 1922, mbasi pala jugosllave nuk sillte asnjë argument të ri të panjohur. Si përfundim, qeveria shqiptare e kryesuar nga Fan Noli, denonconte si agresore qeverinë jugosllave, e cila mbante vazhdimisht të pushtuar ushtarakisht Manastirin e Shën Naumit me ushtritë e saj që përpara Luftës së Parë Botërore.

Gjykata e Hagës nuk u tërhoq. Më 4 shtator 1924 ajo i ktheu përgjigje Këshillit të Lidhjes së Kombeve, se e njihte të drejtë vendimin që kishte marrë Konferenca e Ambasadorëve më 6 dhjetor 1922, i cili ia linte Shqipërisë Manastirin e Shën Naumit. Një muaj më vonë, më 6 tetor 1924, Këshilli i Lidhjes së Kombeve ia përcolli mendimin konsultativ të Gjykatës së Hagës Konferencës së Ambasadorëve, për të njoftuar Tiranën dhe Beogradin, se vendimi i 6 dhjetorit 1922 mbetej në fuqi. Kjo do të thoshte se Jugosllavia duhej t'i tërhiqte ushtritë e saj nga Shën Naumi, mbasi vendimi i Konferencës së Ambasadorëve ishte i prerë, aq më tepër që ai vendim tani kishte miratimin edhe të Gjykatës së Hagës, madje edhe të Lidhjes së Kombeve.



Nëse shkoni në Pogradec, pasi kaloni kufirin e fshatit turistik Tushemisht, ia vlen të vizitoni Manastirin e Shën Naumit. Brenda në manastir ndodhet një kishë e vogël, ku ndodhet varri i Shën Naumit, një dishepull i shekullit X i Shën Klementit të Ohrit dhe njëri prej etërve themelues të krishtërimit ortodoks. Naumi themeloi manastirin e Shën Mihalit dhe u varros më 910. Afresket që ndodhen në kishë janë kopje të origjinaleve të shekullit të XIX. Ikonostasi me gdhendje të pasur i përket vitit 1711, ndërsa ikonat janë të shekullit të XVIII të pikturuara me mjeshtëri nga Kostandini.

Serbët i dogjën sarajet, Zogu iu fali territore

Një zhvillim më të mirë të Shqipërisë pati edhe çështja e pretendimeve jugosllave në krahun e Vermoshit. Më 16 qershor 1924 Konferenca e Ambasadorëve pezulloi vendimin e Komisionit Tellini, i cili ripohonte kufijtë e vendosur në këtë sektor më 1913. Ajo sugjeroi vendimin që kishte marrë një komision i ri. Sipas këtij vendimi, Shqipërisë i lihej pllaja e Velipojës, por i jepej Jugosllavisë lugina e Lumbragës, e cila gjithashtu i takonte Shqipërisë. Edhe këtë vendim qeveria e Nolit e kundërshtoi, pasi për të, çështja e kufirit shqiptaro-jugosllav në sektorin e Vermoshit konsiderohej, njësoj si ajo e Shën Naunit, gjithashtu e përfunduar që më 1913.

Siç shihet, deri në verën e vitit 1924 të gjitha orvatjet e qeverisë jugosllave për të aneksuar me rrugë diplomatike Shën Naumin dhe për të ndryshuar kufirin në sektorin e Vermoshit kishin dështuar. Kjo do të thotë se vija e kufirit, e cila ia linte Shqipërisë Shën Naumin dhe krejt Vermoshin kishte marrë formë të prerë. Dështimi i fundit

i Jugosllavisë ndodhi më 4 shtator 1924. Në pamundësi për të arritur kompromis me qeverinë revolucionare shqiptare, Beogradi kaloi në provokacione kufitare. Pretekstin e fabrikoj vetë - sikur një bandë malësorësh shqiptarë kishte hyrë në zonën malazeze të Kuçit, Triepshit dhe Vasojeviçit dhe kishte rrëmbyer dyqind apo treqind krerë bagëti, madje edhe dy vajza malazeze. Beogradi shtonte se me kundërveprimin e ushtrive malazeze ajo ua kishte marrë grabitësve prenë e grabitur. Gjoja për të vendosur qetësinë në kufi, Beogradi shfrytëzoi një kundërgrabitje pa thënë se kush ishin organizatorët. Kundërgrabitësit, me siguri malazezë, kishin hyrë në zonën e Vermoshit, Tamarës, Grykës, Vuklit dhe Selcës, të cilat i kishin plaçkitur. Shkodra e tronditur qe ngritur në këmbë. Kërkonte nga Tirana mbrojtjen e kufirit dhe zbimin e grabitësve malazezë. Qeveria shqiptare u detyrua të dërgonte forca ushtarake të cilat pas disa përpjekjesh të armatosura i dëbuan grabitësit jashtë kufirit. Më 3 tetor 1924 kur Këshilli i Lidhjes do të vendoste t'ia dërgonte Konferencës së Ambasadorëve opinionin e Gjykatës së Hagës, me porosi që atë t'ia përcillte për zbatim Tiranës dhe Beogradit, arriti në Gjenevë njoftimi për provokacionin e përmendur jugosllav në sektorin e Vermoshit. Në përgjigje të deklaratës së delegatit jugosllav, i cili u përpoq ta frynte konfliktin kufitar dhe t'ia ngarkonte përgjegjësinë palës shqiptare, Fan Noli, i cili merrte pjesë

në seancën e Këshillit të Lidhjes së Kombeve, tha me stilin e tij herë sarkastik, herë politik ndër të tjera:

"Kur dëgjon përfaqësuesin e shtetit jugosllav, shtyhesh të mendosh që e gjithë kjo ka qenë një idil bukolik në shijen më të mirë. Delet dhe viçat po kullosnin (në sektorin e Triepshit - K.F.) përpara syve të vëmendshëm të dy zonjushave, kur papritur arrijnë trimat shqiptarë dhe i rrëmbejnë ato së bashku me delet dhe viçat e tyre. Të afërmit e këtyre zonjushave të këndshme dhe pronarët e deleve dhe të viçave turren në ndjekje, por - mjaft e çuditshme, - të afërmit dhe pronarët zgjedhin si pikë të hyrjes së tyre në territorin shqiptar pikërisht malin e Vermoshit (dhe jo Triepshin - K.F.), pikën e diskutueshme të kufirit. Dhe vjen fundi i trishtuar i kësaj skene hyrëse qesharake. Alarmi gjëmon në Shqipëri. Dërgohen përforcime, bëhet mobilizim, derdhet gjak, sulmuesit zbrapsen".

Këshilli i Lidhjes së Kombeve e mbylli seancën duke mos e marrë në konsideratë protestën e qeverisë jugosllave as për të dënuar Shqipërinë për të ashtuquajturin provokacion kufitar, as për të ndryshuar vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, në favor të Jugosllavisë.

Megjithatë, për shkak të trazirave që ndodhën në Shqipëri, të cilat shkuan drejt shtypjes së Revolucionit të Qershorit, Konferenca e Ambasadorëve nuk ua përcolli menjëherë Tiranës dhe Beogradit dy çështjet e përmendura për njoftim dhe zbatim.

Marrëveshja e A. Zogut me N. Pashiçin



Nikolla Pashiç

Ahmet Zogu

Me triumfin e revolucionit demokratik të kryesuar nga Fan Noli në qershor 1924, Ahmet Zogu me bashkëpunëtorët e tij të ngushtë mërguan në Jugosllavi. Pasi u bind për dobësinë e pushtetit të vet, A. Zogu si një ambicioz i papërmbajtur, iu drejtua për ndihmë qeveritarëve serbë, të cilët dhjetë vjet më parë e kishin bërë shkrumb e hi krahinën e Matit, përfshirë dhe

sarajet ku ai kishte lindur. Me premtimet për ndihmë që mori nga kryeministri serb Nikolla Pashiç, sapo në fillim të gushtit 1924 arriti në Beograd, ai deklaroi se po përgatitej të rivendoste në Shqipëri statusin ligjor të përmbysur nga kryengritësit. Për të justifikuar kundërrevolucionin e tij, ai nuk ngurroi të akuzonte qeverinë demokratike të Fan Nolit se po afrohej me Bashkimin Sovjetik, emri i të cilit në atë kohë shkaktonte alergji në qeveritë borgjeze të mbarë Kontinentit Evropian.

Për të rimarrë pushtetin në Shqipëri, ai u tregua i gatshëm të pranonte pa asnjë rezervë të gjitha kushtet që i diktoi kryeministri i qeverisë jugosllave N. Pashiç. Kështu, më 14 gusht 1924 A. Zogu nënshkroi në Beograd me Nikolla Pashiçin një marrëveshje të fshehtë, të përbërë nga gjashtëmbëdhjetë pika, njëra më e zezë se tjetra. Në bazë të marrëveshjes, qeveria jugosllave premtoi t'i jepte A. Zogut ndihmë politike, ushtarake dhe financiare që të përmbyste Qeverinë e Fan Nolit dhe të rimerrte pushtetin. A. Zogu zotohej nga ana e vet, se pasi të rimerrte pushtetin të përmbushte detyrimet që përmbanin të gjashtëmbëdhjetë pikat e marrëveshjes. Marrëveshja parashihte:

Shqipëria do të realizonte me Jugosllavinë një bashkim personal (neni 1); A. Zogu, i cili do të ishte kryetar i shtetit shqiptar, do të njihte dinastinë e Karagjeorgjeviçëve (neni 2); Qeveria jugosllave do të njihte A. Zogun kryetar shteti dhe do t'i jepte menjëherë një kontribut vjetor shtetëror (neni 3); Shqipëria nuk do të kishte më as Ministri të Luftës, as ushtri kombëtare (neni 4); Shqipëria do të kishte një xhandarmëri aq të fortë sa të ishte në gjendje të mbronte A. Zogun dhe regjimin e kryesuar prej tij (neni 5); Në xhandarmërinë shqiptare do të bënin pjesë edhe oficerë bjellorusë të gjeneralit Vrangeli. Mjetet financiare dhe armët do t'i përballonte Jugosllavia (neni 6); Në xhandarmërinë

shqiptare mund të përfshiheshin edhe oficerë jugosllavë (neni 7); Midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë do të vendoset një bashkim doganor, në bazë të së cilës importimet dhe eksportimet midis dy vendeve do të gëzonin liri të plotë (neni 8); Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jugosllave ngarkoheshin të mbronin interesat e Shqipërisë, e cila hiqte dorë që të kishte përfaqësi diplomatike dhe konsullore të vetat (neni 9); Qeveria shqiptare duhej të deklaronte pranë Konferencës së Ambasadorëve se hiqte dorë nga pretendimi i saj për sovranitetin mbi Manastirin e Shën Naumit dhe mbi lokalitetet e Vermoshit dhe Kelmendit, të cilat do të mbeteshin nën zotërimin e Jugosllavisë (neni 10); Kisha Orto-dokse Shqiptare do të shkëputej nga Patriarkati i Kostandinopojës dhe do të bashkohej me Patrikanën Ortodokse të Beogradit. Po kështu edhe Komuniteti Mysliman Shqiptar do të varej nga Komuniteti Mysliman Jugosllav (neni 11); Qeveria shqiptare nuk do të interesohej për shqiptarët që ndodheshin jashtë kufijve të Shqipërisë. Ajo zotohej të mos pranonte në tokën e saj kosovarët dhe elemente kundërshtarë të politikës jugosllave (neni 12); Për çdo koncesion që Shqipëria do t'u jepte vendeve të tjera ajo duhej të merrte pëlqimin nga qeveria jugosllave (neni 13); Në qoftë se Jugosllavia ndodhet në luftë me Bullgarinë dhe Greqinë, qeveria jugosllave do të kishte të drejtën të rekrutonte në Shqipëri një ushtri prej 25 mijë vullnetarësh për t'i përdorur në frontin jugosllavo-bullgar dhe jugosllavo-grek. Po ashtu, në rast lufte midis Italisë dhe Greqisë - ushtria jugosllave do të kishte të drejtë të pushtonte gjithë tokën shqiptare, për t'i siguruar Shqipërisë territorin e saj nga dyndja eventuale italiane ose greke (neni 14); Qeveria Shqiptare nuk mund t'i deklaronte luftë asnjë shteti pa pëlqimin paraprak të Jugosllavisë (neni 15); Ky traktat (thuhej në nenin 16) do të mbetej sekret dhe nuk mund

të shpallej pa pëlqimin e të dyja palëve. (K. Krisafi. E vërteta e marrëveshjes Zogu-Pashiç. Në: "Tema", 13 shtator 2012).

Sikurse shihet, në rast se marrëveshja do të zbatohet, Shqipëria humbiste pavarësinë dhe kthehej në një provincë jugosllave me një autonomi formale. Veç kësaj, marrëveshja prekte edhe tërësinë territoriale të Shqipërisë - mbasi me zbatimin e saj, Jugosllavia do të aneksonte Manastirin e Shën Naumit dhe krahinën e Kelmendit me qendër Vermoshin (neni 10). Si përfundim, me këtë marrëveshje ogurzezë, A. Zogu shiste sovranitetin dhe integritetin e atdheut, për interesat e veta personale - për të siguruar postin e kryetarit të një shteti formal, pa autoritetin dhe pa dinjitetin që në atë kohë gëzonte shteti shqiptar. Ky akt i turpshëm sa më s'bëhet, u mbajt i fshehtë nga të dyja palët - nga Zogu sepse ai do të fitonte urrejtjen e popullit të vet si tradhëtar i kombit, nga Pashiçi sepse do të ngjallte kundërshtimin e Italisë, e cila në bazë të vendimit që kishin marrë Fuqitë e Mëdha më 9 nëntor 1921, Roma kishte fituar të drejtën të ndërhynte në Shqipëri në rast se pavarësia dhe integriteti i shtetit shqiptar rrezikoheshin nga një fuqi tjetër.

Megjithatë, akti i nënshkruar më 14 gusht 1924, nuk ishte një marrëveshje e lidhur midis dy shteteve, i cili kërkonte medoemos t'i nënshtrohej raktifikimit parlamentar dhe regjistrimit në Lidhjen e Kombeve. Ai ishte një akt midis dy personave - midis një kryeministri, siç ishte Nikolla Pashiçi dhe një ish-kryeministri, siç ishte A. Zogu, i cili tani ishte një refugjat pa asnjë ofiq. Për këtë arsye, marrëveshja nuk ishte një akt zyrtar, por një akt privat. Si e tillë, marrëveshja nuk kishte vlerë shtetërore. Marrëveshja ishte në fund të fundit, një zotim që A. Zogu i jepte N. Pashiçit, se kur të merrte pushtetin në dorë në Shqipëri, do të ndërmernte zbatimin e saj. Pra, nga kjo

pikëpamje, marrëveshja e 14 gushtit ishte një premtim. Natyrisht, ky premtim nuk e çliron A. Zogun nga njolla e turpit.

Marrëveshja u mbajt e fshehtë për gati 60 vjet. Arsyeja përse ajo nuk u shpall menjëherë, kuptohet po të kemi parasysh gurgulenë që do të shkaktonte në Shqipëri nënshkrimi tradhtar i A. Zogut dhe në arenën evropiane zbulimi i planeve ekspansioniste të Pashiçit. Aspirata e Pashiçit për të aneksuar Shqipërinë duke u mbështetur në një marrëveshje private, me siguri që u ngjante ëndërrimeve donkishoteske. Nga ana tjetër, edhe Zogu e dinte fare mirë se nënshkrimi i tij nuk mund ta ndryshonte kursin politik që kishin vendosur Fuqitë e Mëdha dhe ca më pak Lidhja e Kombeve. Atëherë, lind pyetja: përse u nënshkrua marrëveshja e 14 gushtit 1924?

Duket se nga ana e qeverisë jugosllave, marrëveshja u nënshkrua për ta mbajtur nëpërmjet saj nën presion A. Zogun, jo për të realizuar pikat e marrëveshjes, por të paktën për ta mbajtur në krahun e saj. Përkundrazi, nënshkrimi që vuri A. Zogu mund të shpjegohet vetëm me mentalitetin e tij si nip i një derebeu të dikurshëm, të cilët e jepnin me lehtësi fjalën e nderit kur ishte puna për të nxjerrë përfitime personale, pavarësisht se që kur e jepnin fjalën e nderit ishin të prirur që atë ta shkelnin.

Me ndihmat ushtarake dhe financiare që A. Zogu siguroi nga Nikolla Pashiçi - ai ndërmoi kundërrevolucionin, i cili me hyrjen e reparteve të tij në Tiranë më 24 dhjetor 1924, e solli atë në pushtet. Udhëheqësit e Revolucionit demokratik u larguan nga Shqipëria. Rivendosjen e pushtetit konservator ai e quajti "Triumfi i Legalitetit" në vështirimin e rivendosjes së statusit legal që ekzistonte në Shqipëri para se të shpërthente Revolucionin i Qershorit

Formalisht ai rivendosi qeverinë e kryesuar nga Iliaz Vrioni, të cilën e kishte përmbysur Revolucioni i Qershorit. Ahmet Zogu përkohësisht mbajti titullin e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Pas dhjetë ditësh ai e shkarkoi Iliaz



Vrionin dhe përqendroi në duart e veta drejtimin e qeverisë shqiptare.

Më 21 janar 1925 ai e shpalli Shqipërinë Republikë. Më 31 janar Asambleja e shpalli A. Zogun President të saj. Presidenti i Republikës ishte njëkohësisht edhe kryetari i qeverisë shqiptare. Republika që shpalli Zogu nuk qe as presidenciale, as parlamentare, as demokratike. Ajo qe një republikë despotike, ku të gjitha fijet e pushtetit përqendroheshin në duart e A. Zogut. Pushtetin

legjislativ do ta ushtronin dy Dhoma - Parlamenti dhe Senati. Pushteti legjislativ i dy Dhomave ishte formal. A. Zogu si kryeministër ishte i detyruar t'ua paraqiste Dhomave për miratim projektligjet e saj. Ndryshimet që mund të pësonte një projektligj i qeverisë nga dy Dhomat legislative, duhej të miratoheshin nga Presidenti i Republikës. Pra, projektligjet e propozuara nga A. Zogu si kryeministër, ktheheshin në dekretligje vetëm nëse i nënshkruante A. Zogu si President i Republikës.

Sapo rivendosi pushtetin e vet, A. Zogu vendosi të çlirohej nga detyrimi që kishte marrë ndaj Nikolla Pashiçit me marrëveshjen

e fshehtë të 14 gushtit 1924. Për këtë qëllim, atij i duhej të siguronte një mbështetje të fuqishme në arenën ndërkombëtare. Mbështetjen e gjeti tek Italia fashiste. Derisa të realizonte marrëveshjen me Italinë fashiste, Zogut i duhej të vinte në gjumë qeverinë jugosllave. Për këtë qëllim ai emëroi në qeverinë shqiptare në krye të dikastereve më të rëndësishme, dy ministra me prirje kontradiktore - Ceno beg Kryeziu ministër i Punëve të Brendshme dhe Myfit bej Libohovën ministër i Financave dhe zv.ministër i Punëve të Jashtme.



Zogu me Ceno Kryeziu

Ceno beg Kryeziu ishte kunati i Ahmet Zogut. Kishte nënshtetësi jugosllave. Njihej botërisht se ishte përkrahës (dikush thotë edhe agjent) i lidhjes së ngushtë të Shqipërisë me Mbretërinë e Jugosllavisë. Përkundrazi, Myfit Libohova njihej si agjent i Romës. Sikurse ka shkruar në kujtimet me titull "Politika ime në

Shqipëri", Vlorë 1920, ai ishte përkrahës i përfshirjes së Shqipërisë nën protektoratin e Italisë.

Në fillim riardhja në pushtet e A. Zogut nuk u pa me sy të mirë në Romë. Para së gjithash, ajo dyshonte për marrëveshjen Zogu-Pashiç të 14 gushtit 1924, tekstin e së cilës Roma e shtiu menjëherë në dorë, si nëpërmjet Beogradit ashtu dhe nëpërmjet Tiranës. Dyshimet në Romë u shtuan nga ndihma dhe përkrahja që Zogu për të rimarrë pushtetin siguroi nga Jugosllavia, rivalja e Italisë në detin Adriatik dhe në Gadishullin Ballkanik. Megjithatë, hapi që ndërmoi Zogu duke trokitur në dyert e Italisë, në Romë u prit mirë, ndonëse në fillim me ndonjë rezervë.

Marrëveshjen me Italinë Zogu e konsolidoi duke nënshkruar me Romën dy koncesione të rëndësishme - koncesionin e nxjerrjes së vajgurit nga rezervat që mbante nëntoka shqiptare dhe koncesionin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, si institucion financiar i monedhës dhe i kreditit, me të drejtë absolute të prerjes së monedhës kombëtare të Shqipërisë. Nga ana e saj, Roma i premtoi Shqipërisë po atë vit (1925) një hua të konsiderueshme prej 50 milionë frangash ari për ndërtime botore.

Bisedimet shqiptaro-jugosllave



Pasi siguroi mbështetjen e Italisë, për të rregulluar marrëdhëniet me Jugosllavinë, A. Zogu ngarkoi zyrtarisht Myfit Libohovën zv.ministrin e Punëve të Jashtme. Në të njëjtën kohë, ai porositi Mehdi Frashërin, përfaqësuesin shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Kufijve pranë Konferencës së Ambasadorëve, që të hynte në bisedime me homologun e vet jugosllav Palankoviçi për të gjetur një kompromis. Edhe

në këtë rast, Zogu nuk mund të gjente njeri më të përshtatshëm se Mehdi Frashëri për të bërë lëshime në dëm të sovranitetit dhe të integritetit tokësor të Shqipërisë. Mehdiu krenohet në "Kujtimet" e veta se më 1914 ishte ai që kishte propozuar

Protokollin e Korfuzit, me të cilin qarqet e Gjirokastrës dhe të Korçës fitonin autonominë me karakter grek të të ashtuquajturit Vorio-Epir. (Mehdi Frashëri. Kujtime. Vitet 1913-1933. Tiranë 2005).

Më 11 janar 1925 Myfit Libohova si zv.ministër i Punëve të Jashtme, i dërgoi këtë mesazh Mehdi Frashërit, i cili në atë kohë ndodhej në Firenze (Itali): "Pasi të përfundoni misionin tuaj në Firenze, ju lutem të ktheheni në Paris ku do t'ju duhet të përpiqeni me të gjitha mundësitë për të siguruar zgjidhjen përfundimtare të këtyre dy çështjeve në favorin tonë të plotë. Duhet patjetër të ngulni këmbë për mbrojtjen e vijës caktuar fillimisht nga Komisioni i Kufijve në sektorin e Manastirit të Shën Naumit, duke thënë se çdo korrigjim në kurrizin tonë do të ishte një shkelje e interesave legjitime dhe thelbësore të Shqipërisë. Megjithatë, nëse do të ishte e pashmangshme të bëhej një korrigjim i lehtë në favor të Serbisë në këtë sektor, ju duhet të kërkonte një kompensim të mjaftueshëm nga ana e Vermoshit, duke ia lënë sigurisht manastirin Shqipërisë. Ne jemi absolutisht kundër çdo lloj ndryshimi nga ana e Vermoshit, pasi e konsiderojmë se kjo çështje është gjykuar. Është e pamundur të pranohet qoftë edhe më i vogli ndryshim për sa i përket kësaj çështjeje në dëm të interesave tona. Gjithashtu ju nuk duhet të pranoni asnjë sugjerim në lidhje me një marrëveshje të drejtpërdrejtë midis nesh dhe Jugosllavisë, për një zgjidhje të mundshme të çështjeve të sapocekura". (K. Naska. Shën Naumi dhe diplomacia e kohës. Tiranë 2012, f. 560).

Me një fjalë, Myfit Libohova, zv.ministri i Punëve të Jashtme i jepte tri porosi Mehdi Frashërit: a) Të mos bënte asnjë lëshim territori në sektorin e Vermoshit, mbasi vendimi i Komisionit të Kufirit ka qenë përfundimtar; b) Nëse në sektorin e Manastirit të

Shën Naumit korigjimi i kufirit është i pashmangshëm, Mehdi Frashëri autorizohej të bënte një korigjim të "lehtë" në këtë sektor në favor të Serbisë, me kusht që Shqipëria të kompensohej me një territor të mjaftueshëm në sektorin e Vermoshit, por në çdo rast Manastiri i Shën Naumit t'i mbetej Shqipërisë; c) Të mos pranonte nga Beogradi asnjë sugjerim që këto dy probleme të zgjidheshin me marrëveshje të drejtpërdrejta midis dy palëve.

Një muaj më vonë, në shkurt të vitit 1925 erdhi në Tiranë i dërguari i posaçëm i qeverisë jugosllave për të lidhur marrëveshjen mbi çështjen e Vermoshit dhe të Shën Naumit. Në përgjigje Këshilli i Ministrave mori dy vendime: a) Të dërgonte një komision të posaçëm në Vermosh dhe në Shën Naum për të parë në vend ndryshimin e kufijve që propozonte Beogradi; b) Të merrte mendimin e Mehdi Frashërit nëse propozimi jugosllav ishte ose jo në favorin shqiptar. (Po aty, f. 564).

Në "Kujtimet" e veta Mehdi Frashëri flet për takimet që pati me homologun jugosllav Palankoviç, përmend drekat e darkat që hëngri me të, por nuk jep asnjë shpjegim sesi rrodhën bisedimet mbi Manastirin e Shën Naumit dhe mbi territorin e Vermoshit. Pavarësisht nga heshtja e tij, trajtimi i dy çështjeve gjatë javëve të mëvonshme lë të kuptohet se Mehdi Frashëri dhe Palankoviçi arritën në një marrëveshje verbale. Sipas saj, duket se Mehdi Frashëri u autorizua nga A. Zogu të vepronte ndryshe nga udhëzimi i Myfit Libohovës: të kërkonte nga Konferenca e Ambasadorëve që të pranohej propozimi i Beogradit për të pritur derisa të përfundonin bisedimet që do të zhvillonin të dyja palët për zgjidhjen e dy çështjeve të kufirit. Pra, Tirana pranonte që kufiri shqiptaro-jugosllav, i cili ishte vendosur përfundimisht nga të gjitha instancat ndërkombëtare, të vihej përsëri në

diskutim. Ky lëshim i pamotivuar juridikisht dhe diplomatikisht ia hapi rrugën, siç do të shihet, cenimit të padrejtë të integritetit tokësor të Shqipërisë.

Gjithnjë me pëlqimin e Mehdi Frashërit, Beogradi njoftoi Konferencën e Ambasadorëve se kishte rënë në ujdi me Tiranën për "shkëmbime" terriroresh si në Manastirin e Shën Naumit ashtu edhe në sektorin e Vermoshit. Për çfarë "shkëmbime" terriroresh bëhej fjalë? Sipas shpjegimeve që Mehdi Frashëri ka dhënë më 19 korrik 1925 në mbledhjen plenare të të dyja Dhomave Legjislative të Shqipërisë (Senatit dhe Parlamentit), ato qenë:

Në sektorin e Shën Naumit Beogradi propozonte që manastiri me fushën e vet t'i kalonte Jugosllavisë, kurse Jugosllavia nga ana e saj i jepte Shqipërisë fshatin Piskupat, fshatin Lubanisht dhe pjesën e sipërme të luginës së Çërravës. Ky ishte një mashtrim i mirëfilltë, mbasi fshatrat Piskupat, Lubanishtë dhe pjesa e sipërme e luginës së Çërravës që gjoja Jugosllavia ia jepte Shqipërisë, bënë pjesë në kazanë osmanë të Korçës, të cilën Konferenca e Ambasadorëve ia kishte njohur në mënyrë përfundimtare tërësisht Shqipërisë që me protokollin e 11 gushtit 1913. Pra, Jugosllavia merrte përsipër t'i kthente Shqipërisë si kompensim një territor që Konferenca e Ambasadorëve ia kishte njohur Shqipërisë që në vitin 1913.

PJESA III

Debatet në Asamble, si u
ndryshua Kushtetuta për
Shën Naumin



Pandeli Evangjeli

3

1

2

Debatet në Asamblenë Legjislative për fillimin e marrëveshjes së kufirit (17-19 korrik 1925)

Debatet që u zhvilluan në Asamblenë Legjislative, - në mbledhjen e përbashkët të të dyja Dhomave Legjislative, Senatit dhe Parlamentit - të cilat vazhduan tri ditë (17-19 korrik 1925), në lidhje me kufirin e ri shqiptaro-jugosllav në sektorin e Shën Naumit dhe në atë të Vermoshit, deri sot nuk janë trajtuar në fushën e historiografisë. Procesverbalet e këtyre bisedimeve kanë qenë botuar në Fletoren Zyrtare të kohës kushtuar bisedimeve të Asamblesë Legjislative, të cilat, për shkak të ekzemplarëve tepër të rrallë, janë të shfrytëzueshme me vështirësi nga publiku i interesuar. Për fat të mirë, këto kohët e fundit procesverbalet e bisedimeve të dyja Dhomave Legjislative janë përfshirë në vëllimin e botuar nga Kaliopi Naska, "Shën Naumi dhe diplomacia e kohës". Tiranë 2012.

Më 16 korrik 1925 u bë mbledhja plenare e të dyja Dhomave Legjislative të Republikës - Parlamentit dhe Senatit, - nën kryesinë e Eshref Frashërit. Në rend të ditës ishte shkresa e kryetarit të qeverisë, me të cilën A. Zogu kërkonte autorizimin për të filluar bisedime me palën jugosllave me objekt "shkëmbim" territoresh në sektorin e Shën Naumit dhe në atë të Vermoshit. Me shkresën e vet, A. Zogu kërkonte si President i Republikës që mbledhja të bëhej e fshehtë. Jo pak asamblistë kërkuan që mbledhja të bëhej e hapët. Më në fund, u vendos që mbledhja të bëhej e fshehtë. Për këtë arsye, debatet e zhvilluara nga asamblistët nuk i njohim. Në të njëjtën kohë, mbledhja plenare ngarkoi komisionet e Punëve të Jashtme të të dyja Dhomave Legjislative të merrnin në shqyrtim kërkesën e kryetarit të qeverisë.

Për t'i dhënë kohë Komisioneve të Punëve të Jashtme që të hartonin rezolutën, mbledhja plenare u vendos që të fillonte ditën e nesërme. Të nesërmen, më 17 korrik kur u hap mbledhja, kryetari i saj Eshref Frashëri njoftoi se Myfit Libohova nuk ishte dakord me kërkesën e Presidentit të Republikës që mbledhja plenare i kishte zhvilluar punimet e saj me dyer të mbyllura. Kërkesa e tij për mbledhje me dyer të hapura u pranua. Më pas u lexua rezoluta e përbashkët e dy Komisioneve të Punëve të Jashtme nga Xhemil Dino, sekretari i seksioneve të Punëve të Jashtme. Të dy seksionet i propozonin mbledhjes plenare që ta miratonin kërkesën e qeverisë shqiptare për të hyrë në bisedime me palën jugosllave për "shkëmbim" territoresh në sektorin e Shën Naumit dhe në atë të Vermoshit. Kështu filluan debatet.

Deputeti Ferit Vokopola kërkoj nga Mehdi Frashëri, delegati shqiptar në Komisionin e Kufirit, që t'i jepte mbledhjes plenare shpjegime se çfarë propozonte pala jugosllave për ndryshimin e

kufirit. Meqenëse shpjegimet që M. Frashëri dha në mbledhjen e djeshme kanë qenë të fshehta - tha F. Vokopola, - ato duhet të përsëriten edhe sot në mbledhjen e hapët, mbasi është e domosdoshme që kërkesat e palës jugosllave dhe pikëpamjet e qeverisë shqiptare t'i dijë edhe publiku.

Duke iu përgjigjur Ferit Vokopolës, Mehdi Frashëri pohoi se fjala e deputetit të Lushnjës ishte thjesht një "demagogji". "Populli, - pohoi ai, - është si një çilimi, të cilin mund ta bësh të qajë apo të qeshë me pak fjalë. Megjithatë, vazhdoi ai, meqenëse populli shqiptar është patriot, atij duhet t'i thuhet gjërat që i nevojiten". (Po aty, f. 595). Gjatë regjistrimit të debateve vihen re disa formulime kontradiktore të Mehdi Frashërit. Kur njoftoi se Konferenca e Ambasadorëve ia përcolli më 27 prill 1925 vendimin përfundimtar se Shën Naumi dhe zona e Vermoshit i takonin Shqipërisë, - M. Fra-shëri shtoi se së bashku me këtë njoftim Konferenca ia përcolli Shqipërisë edhe propozimin e Jugosllavisë për ta zgjidhur çështjen e kufirit me marrëve-shje dypalëshe.

Përkundrazi, gjatë shpjegimeve që dha Mehdi Frashëri, ai flet sikur Konferenca e Ambasadorëve kishte marrë vendim që çështja e kufirit të zgjidhej midis dy palëve. Në relacionin e seksionit të punëve të jashtme, flitet qartë se ajo kishte marrë në shqyrtim jo vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, i cili nuk kishte përse të diskutohej pasi ishte në favor të Shqipërisë, por propozimin e palës jugosllave, të cilën e kishte përcjellë Konferenca e Ambasadorëve. Në relacion thuhej tekstualisht: "Qeveria shqiptare mbas këshillave (pra jo vendimeve - K.F.) dy herë të përsëritura të Konferencës së Ambasadorëve u ndodh përpara disa propozimeve të Qeverisë Jugosllave, për çka i përket Shën Naumit dhe një pjese të Velipojës në zonën e

Vermoshit". (Po aty, f. 592). Siç shihet, pretendimi i Mehdi Frashërit ishte një shtrembërim i të vërtetës. Konferenca e Ambasadorëve nuk kishte të drejtë të kërkonte pëlqimin e të dyja palëve për një vendim që kishte marrë formë të prerë, i cili kishte gjetur miratimin jo vetëm nga Konferenca e Ambasadorëve, por edhe nga Gjykatorja e Hagës, madje edhe nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve.



Mehdi Frasher

Mehdi Frashëri shtoi ndër të tjera se për të hyrë në bisedime me palën jugosllave ishte mbështetur në një vendim të qeverisë së Tiranës. Madje, shtoi, se edhe ai personalisht e kishte miratuar këtë vendim, mbasi Shqipëria po të jepte Manastirin do të merrte fshatin Piskupat të banuar nga rreth 60 familje shqiptare dhe një sipërfaqe katër herë më të madhe se ajo që po jepte. Edhe lëshimin e pyllit të Velipojës në sektorin e Vermoshit ai e kompensoi me disa përfitime, të

cilat Beogradi i dha pa asnjë garanci.

"Unë, - theksoi Mehdi Frashëri, - ja kam propozuar qeverisë që t'i kërkojmë Jugo-sllavisë një copë bjeshkë që ndodhet në mes të Bajcës e të Libovicës, që është pronë e Bajrakut të Vuklit (të cilën Beogradi nuk e pranoi - K.F.). Tani, nënvizoi ai, Parlamenti dhe Senati të bëjnë çfarë të duan". (Po aty, f. 598). Siç shihet, këtu po vazhdon loja e volejbollit: Zogu ngarkoi Myfit Libohovën, ky ia la topin në dorë Mehdi Frashërit, kurse ky, nga ana e tij, e hodhi topin në fushën e Asamblesë.

Ministrit të Punëve të Jashtme nuk i pëlqeu shprehja e Mehdi Frashërit se qeveria kishte marrë vendim për të shkëmbyer Shën Naumin (në favor të Jugosllavisë) me fshatin Piskupat (në favor të Shqipërisë). Ai tha, sipas procesverbalit, tekstualisht: "Më duket se zoti delegat (Mehdi Frashëri - K.F.) gabimisht tha se Qeveria ka marrë një vendim për shkëmbimin e Shën Naumit me Piskupatin". Për të shkarkuar veten nga përgjegjësia, ai vazhdoi: "Qeveria, zotë-rinj, nuk ka marrë ndonjë vendim dhe çështjen jua ka paraqitur Juve për vendim. Në është se ju pranoni që të bëhet një shkëmbim, atë-herë qeveria do të hyjë në marrëveshje. Kur t'i mbushet mendja që shkëmbimi është në dobi të popullit dhe të shtetit dhe nuk i sjell dëm si moral ashtu dhe material, qeveria do të hyjë në pazarllëk. Përndryshe, qeveria nuk bënë një shkëmbim".

Pas tij e mori fjalën deputeti Mihal Kaso. Qeveria, tha ai, e ka për detyrë që të mbrojë interesat e shtetit dhe të popullit. Lëshimi i Shën Naumit "është me të vërtetë një hidhërim për ne si shqiptarë, por është dhe një hidhërim veçanërisht për ne orthodoksët, mbasi humbim Manastirin e Shën Naumit". Ai e mbylli debatin e vet duke thënë: "Qeveria ka ndoshta frikë që të marrë një vendim të tillë (i cili dëmton popullin), por ne duhet t'i japim kurajë dhe të marrim përgjegjësinë dhe të autorizojmë qeverinë dhe kësaj çështje t'i japim kështu përfundimin, siç e kërkon nevoja dhe interesi". (Po aty, f. 599).

Deputeti Kol Mjeda bëri një propozim interesant: "Përderisa ministri i Punëve të Jashtme kërkon autorizimin tonë për të hyrë në pazarllëk me qeverinë jugosllave dhe përderisa është fjala për shkëmbim terriroresh, - tha Kol Mjeda, - që përkundrejt Manastirit të Shën Naumit, Jugosllavia t'i jepte Shqipërisë Hotin, Grudën dhe Triepshin. Ai linte të kuptohej se territori që

Beogradi propozonte për shkëmbim të Shën Naumit ishte pa vlerë.

Deputeti Ndrek Kiçi nuk ishte dakord për shkëmbimin e propozuar nga pala jugosllave. Premtimet e Beogradit për "hapje rrugësh", për "treg të lirë", për "heqje takse doganore", për "heqje takse pasaportash", këto - theksoi ai, - nuk më gëzojnë aspak, mbasi po na lejnë si "një trup pa këmbë e pa duar". "Vermoshi, zotërinj, për malësitë tona ka një rëndësi të veçantë. Për to është humbja e fikja (vdekja). Ju lutem zotërinj, - përfundoi ai, - të mendoni pak se ç'po heqin që nga viti 1913 malësitë tona. Gati 100 shtëpi nga Kelmendi, Nikçi dhe Vukli janë larguar dhe po largohen nga ato anë, mbasi nuk kanë mjet jetese... Prandaj ju lutem shumë, këtë çështje ta lëmë për në vjeshtë". (Po aty, f. 600).

Deputeti Selaudin Blloshmi, pasi kujtoi se historia e Shqipërisë ishte një histori shkëputje terriroresh, kur erdhi te shkëmbimi i Shën Naumit dhe i pyllit të Vermoshit, tha: "Humbja e 4 mureve të Manastirit dhe e pyllit të Vermoshit, kundrejt humbjeve të mëparshme janë shumë të vogla. Shkëputja e tyre nga ne është e hidhët, sepse ato kanë rëndësi politike, strategjike dhe historike. Por kur kemi një milion e ca shqiptarë, që janë jashtë kufirit tonë, ato katër mure nuk mund të luajnë ndonjë rol... Ne prisnim nga Fuqitë e Mëdha që t'i jepnin Shqipërisë tokat që i takonin, por ata fatkeqësisht na dhanë vetëm katër muret e Manastirit. Se çfarë roli mund të lozë dhe çfarë rëndësie mund të ketë Shën Naumi me këto përmasa e kupton secili. Po të kishte rrethinat atëherë po, do të kishte rëndësi. Ndonëse Fuqitë e Mëdha dhe Gjykatorja e Hagës na e ka dhënë Shën Naumin, fqinji ynë nuk do që ta lëshojë. Fuqitë e Mëdha, kur kanë formuluar vendimin e tyre, me një dorë na e kanë dhënë të

drejtën dhe me dorën tjetër atë na e kanë marrë, veçse na kanë lënë (trashëgim) një grindje të mërzitshme. A ia vlen që për një pikë të tillë të hapet një luftë? Të thuash jo, është keq, të thuash po, 'po'-ja ka problemet e veta". Përfundimisht, S. Blloshmi ishte dakord me rezolutën e Komisionit të Punëve të Jashtme.

Xhemil Dino e mbrojti tezën e rezolutës së Komisionit me këto argumente: se dinjitetin kanë mundësi ta mbrojnë vetëm Fuqitë e Mëdha, kurse shtetet e vegjël janë të destinuara të bëjnë lëshime në dëm të dinjitetit. Megjithatë, sipas tij, Shqipëria ka përfitime nga marrëveshja e propozuar nga pala jugosllave, mbasi "Shqiptarët do të kenë liri të plotë të hyjnë e të dalin pa pasaporta e të bëjnë tregti pa paguar taksë doganore". (Po aty, f. 63). Këtu pati zëra që e vunë në dyshim saktësinë e këtyre përfitimeve dhe se kërkuan garanci për to. Xh. Dino u përgjigj se nuk ishte ai, por qeveria që duhej të jepte garanci për realizimin e këtyre premtimeve.

Më pas e mori fjalën deputeti Fiqiri Rusi. Ai pohoi se ndryshimi i kufirit u propozua jo siç njoftoi Mehdi Frashëri, nga Konferenca e Ambasadorëve, por nga qeveria jugosllave. Në këtë mënyrë, Konferenca tërthorazi plotësoi dëshirën e Jugosllavisë në kurrizin tonë. Propozimi që i bëhet qeverisë shqiptare për shkëmbim tokash unë nuk di, theksoi ai, nëse është ose jo në përfitim të shtetit shqiptar. Por, meqenëse, sipas tij, Fuqitë e Mëdha nuk e përkrahnin Shqipërinë, ai mendonte se dy Dhomat Legjislative ta përkrahnin përfundimin e marrëveshjes së qeverisë shqiptare me qeverinë jugosllave, me besim të plotë se qeveria do ta ruante nderin e Shqipërisë.

Deputeti Rauf Fico pohoi çiltazi se "katër muret e kishës së Shën Naumit për mua nuk kanë ndonjë vleftë. Thuhet se për këto do



Rauf Fico

të na japin Piskupatin, ku ka dhe atje një kishë, e cila do të zërë vendin e kishës së Shën Naumit" (Duket se ai nuk e kishte të

qartë se një kishë fshati nuk mund të zëvendësojë nga pikëpamja institucionale dhe fetare një manastir). Në lidhje me Vermoshin, ai pohoi se pylli i Velipojës ka qenë kurdoherë shkak grindjesh midis shqiptarëve dhe malazezëve. Ai pohoi se, sipas të drejtës ndërkombëtare dhe vendimeve të Gjykatores së Hagës, ai pyll i takonte Shqipërisë. Por "mjerisht, - nënvizoi ai, - fati ynë nuk po na do. Shqipëria ka pësuar operacione pas operacionesh: humbi Kosovën, humbi Çamërinë, humbi një milion e ca prej bijve të saj, të cilët gjenden jashtë kufijve të Shqipërisë. Tani po i bëhet edhe një operacion tjetër. Na thonë të japim Velipojën, Shën Naumin. Por këto pse do t'i japim? Dua të them zoti kryetar, se e drejta në vetvete nuk ka vleftë. Kush ka fuqinë, e ka të drejtën në dorë. Mbasi do t'i humbasim këto vise, do të pësojmë një operacion tjetër në kurrizin e ardhmërisë tonë. Në mos tjetër, ajo që qeveria shqiptare duhet të përfitojë nga ky shkëmbim është të kërkojë nga Beogradi hapjen e shkollave shqipe në Kosovë ku kemi më tepër se një milion vëllezër tanë. Të kërkojmë ngritjen e konsullatave tona në Shkup e në Prizren. Në Shkodër ku banon një pjesë fare e vogël serbësh, rreth 1500 frymë, Jugosllavia ka një konsullatë dhe një shkollë për ta. Jemi pra, të shtrënguar t'i japim leje qeverisë tonë të hyjë në marrëveshje me qeverinë jugo-sllave. Rauf Fico duhet ditur se kjo është një plagë e pashërueshme në zemrat dhe në trutë tona". Rauf Fico e përfundoi fjalën e tij me një thirrje patetike: "Ashtu siç serbët pritën katër shekuj për të plotësuar idealin e tyre, ashtu do të presim edhe ne. Do t'i drejtojmë nipërit e stërnipërit tanë dhe dikur shkarazi, barkazi një ditë do të vemi në Kosovë, nën hijen e shkabës dykrenare". Fjala e tij pati duartrokime të vazhdueshme. "Pra, - vazhdoi ai, - i jap leje qeverisë dhe e porosis edhe një herë të nguli këmbë për të dërguar konsull në Shkup e në Prizren dhe të çeli në vende të

tjera (të Kosovës - K.F.) shkolla shqipe, mbasi të drejtat janë reciproke".

Tef Gera kërkoi nga qeveria që në marrëveshjen me Jugosllavinë të përfshihej edhe liria e katundeve të malit të Krajes për të vizituar lirisht tregun e Shkodrës.

J. Erebara deklaroi se e linte çështjen në dorë të qeverisë për ta zgjidhur siç ishte në interes të Shqipërisë. Ferit Vokopola shpjegoi edhe një herë arsyen përse populli duhet të dijë se si qëndron e vërteta, me qëllim që "përgjegjësinë ta kemi së bashku me të". Pastaj ai kaloi në trajtimin e dy problemeve të kufirit. "Shteti përbëhet, - tha ai, - nga kombi, toka (territori - K.F) dhe organizata e qeverisë (administrata shtetërore - K.F.). Kur cenohet toka, është cenuar krejt organizata. Nga bisedat që u mbajtën këtu mbi pikën e Shën Naumit e mbi pikën e Vermoshit, kuptohet se nuk janë lënë toka të mëdha... Sipas shpjegimeve që na dha delegati ynë, Vermoshi i mbetet Shqipërisë dhe vetëm një pjesë të tij kërkon qeveria jugosllave... Delegati i qeverisë, si dhe relatori i komisionit na thanë se po lëmë Shën Naumin me një region 750 metrash dhe në tjetrën anë po marrim fshatin Piskupat, ku banojnë 50-60 familje shqiptare me 500 frymë". (Po aty, f. 606). Pastaj pyeti: A e cenon kjo vepër prestigjin e kombit dhe a e siguron interesin e tij? "Unë jam i mendimit, se duhet të kemi kurajë civile dhe ta themi çiltas se kjo vepër nuk e cenon prestigjin e kombit. Prandaj jam i mendimit të autorizojmë qeverinë tonë që të hyjë në marrëveshje me qeverinë jugosllave". (Po aty, f. 606). Ai shtoi se e njëjta gjë ndodhi edhe në sektorin e Vermoshit: Edhe këtu Shqipëria jep dhe merr. Veç kësaj, Shqipëria "fiton lehtësira tregëtije dhe komunikacioni".

Përfundimisht, edhe ai pranoi të autorizoj qeveria që të fillonte bisedimet me palën jugosllave për zgjidhjen e çështjes së kufirit. (Po aty, ff. 606-607).

Mbasi mbaruan debatet e senatorëve dhe të deputetëve, kryetari i Asamblesë, Eshref Frashëri, u kujtua se me këtë debat ishte shkelur neni 2 i statutit themeltar në të cilin thuhej se kufijtë e Shqipërisë ishin të paprekshëm. Për këtë arsye, para se të vihej në votim kërkesa për të autorizuar qeverinë që të hynte në bisedime me palën jugosllave për shkëmbim territore, ai shpjegoi detyrimin që kishin të dyja Dhomat për ta përlegjur ndryshimin e kufirit me Statutin themeltar, i cili në nenin 2 në të vërtetë e ndalonte kategorikisht çdo cenim apo prekje të kufirit shtetëror. "Nëse kemi të bëjmë me një shkëmbim territore pa u ndryshuar artikulli numër 2 i Statutit, - nënvizoi ai, - do të bëjmë një vepër antikushtetore. Prandaj është e domosdoshme që më parë t'i shtojmë një paragraf të vogël nenit 2 të Statutit dhe vetëm pasi të pranohet kjo shtojcë, atëherë mund të vihet në votë kërkesa e qeverisë për "shkëmbim" territore dhe çështja të marri përfundimin e duhur". (Po aty, f. 607). Ai iu kujtoi asamblistëve se "ndërrimi i Statutit bëhet me 2/3 e votave të mbledhjes legislative duke u mbledhur të dyja Dhomat bashkë". Përfundimisht, miratimi i shtojcës së nenit 2 të Statutit dhe pas tij miratimi i rezolutës së Komisioneve të Punëve të Jashtme u la për ditën e nesërme më 18 korrik. (Po aty, f. 607).

Të nesërmen, më 18 korrik, punimet e Asamblesë Legislative u zhvilluan me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Arsyeja që e shtyu Asamblenë Kushtetuese të zhvillonte tri mbledhje brenda pak orëve për të plotësuar një nen të Statutit të Republikës qëndron te interesi i Presidentit të Republikës për ta mbyllur sa më parë çështjen e ndryshimit të kufirit. Në fakt, më 18 korrik të

dy Dhomat Legislative - Senati dhe Parlamenti - zhvilluan në të njëjtën kohë në orën 9 të mëngjesit mbledhje të veçanta për të hartuar secila më vete shtojcën e nenit 2 të Statutit. Brenda një ore kryetari i Senatit hartoi dhe miratoi shtojcën e nenit 2 të Statutit, të cilën ia përcolli me shkresë kryesisë së Parlamentit. Nga ana e tij, Parlamenti pasi e lexoi dhe e miratoi shtojcën, ia përcolli kryesisë së Senatit. Më në fund, kryesia e Senatit ia përcolli tekstin përfundimtar të shtojcës për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare të të dyja Dhomave Legislative. Gjithë ky proces dypalësh, me gjithë ecejaket e shtojcës u krye brenda një ore. Kështu, në orën 10 të mëngjesit filloi debati mbi shtojcën e nenit 2 të Kushtetutës.

Mehdi Frashëri gjeti një zgjidhje të ngjashme edhe në çështjen e kufirit në sektorin e Vermoshit, edhe këtu në dëm të palës shqiptare. Edhe në këtë sektor, Shqipëria i dhuronte Jugosllavisë pjesë të territorit të saj dhe merrte si shkëmbim territore që i qenë njohur Shqipërisë që më 1913. Madje, premtimet që Beogradi i jepte Shqipërisë se do t'i lejonte banorët e Kelmendit të punonin tokat që tani do t'i kalonin Malit të Zi dhe fshatarët e zonës kufitare që të frekuentonin lirisht dhe pa doganë tregjet e Prizrenit, Gjakovës dhe Dibres - nuk përmbanin asnjë garanci se pala jugosllave do t'i respektonte ashtu siç në të vërtetë më vonë nuk i respektoi.

Të dyja këto propozime, A. Zogu si kryetari i qeverisë ia përcolli për miratim, në përputhje me Kushtetutën, të dyja Dhomave Legislative të Shqipërisë.

Kur në orën e caktuar u hap seanca plenare, debati filloi me një çështje që nuk parashihej në rend të ditës. Para se të shqyrtohej shtojca e nenit 2, deputeti Vasil Bamiha ngriti çështjen parimore

se shtojca nuk kishte të bënte me bisedimet qeveritare me palën jugosllave, por me një dispozitë që prekte Statutin themeltar. Si rrjedhim, atë nuk duhej ta trajtonte Komisioni i përbashkët i Punëve të Jashtme, por, sipas tij, Komisioni Juridik, pasi këtij i përkisnin çështjet që preknin statutin. Kryetari i Asamblesë Legjislative, Eshref Frashëri, i cili ishte ai që e kishte caktuar Komisionin e Punëve të Jashtme, e mbrojti tezën e vet duke thënë se qëllimi i shtojcës kishte të bënte jo me çështje juridike, por me ndryshim territoresh, të cilat i përkisnin marrëveshjet e shtetit me fuqitë e tjera. Madje, me këtë rast deputeti Bamiha protestoi për nismën që kishte marrë qeveria për ndryshimin e kufirit.

Pas një pushimi të shkurtër, siç duket për të qetësuar tensionin që u ndje në sallë, mbledhja pranoi propozimin e kryetarit, që shtojca e nenit 2 të trajtohej nga Komisioni i Punëve të Jashtme nga të dyja Dhomat bashkërisht, i cili kryesohej nga Pandeli Evangjeli. Teksti i shtojcës të nenit 2 të statudit i hartuar nga Komisioni ishte ky: "Asnjë ndryshim i kufirit nuk mund të bëhet veç se me një vendim të marrun pas dispozitave të parapame në artikullin 141 të këtij statuti". Në bazë të kësaj shtojce, qeveria për çdo ndryshim të kufirit duhet të merrte miratimin e dy Dhomave Legjislative, të cilin duhet ta pranonin jo më pak se dy të tretat e votave të përbashkëta. Nëse do të pranohej teza e V. Bamihas se shtojca e nenit 2 ishte një çështje juridike, atëherë duhej të ndryshonte procedura që kishte ndjekur Asambleja Legjislative: shtojca duhej të shqyrtohej jo nga Komisioni i Punëve të Jashtme, por nga Komisioni Juridik. Madje, shtojca duhej të shqyrtohej jo nga mbledhja e përbashkët e të dyja Dhomave, por nga dy Dhomat veç e veç dhe të miratohej nga secila dhomë me dy të tretat e votave të tyre.

Ibrahim Xhindi nguli këmbë se ky plotësim i nenit 2 nuk ka lidhje me ndryshimin e kufirit, por me statutin. (Në tekst ndërpritet fjalia, sigurisht ka dashur të thotë se i përket Komisionit Juridik dhe jo Komisionit të Punëve të Jashtme). Sipas Mihal Kasos, neni 141 i Statutit thotë se çdo ndryshim i statudit merret me dy të tretën e votave të mbledhjes së përbashkët të të dyja Dhomave. Ai mendonte se "Komisioni e quajti të nevojshëm që ndryshimin e kufirit ta vënë nën mbrojtje të dispozitave të Statutit". Ai shtoi se "çdo ndryshim i kufirit të shtetit duhet të hyjë nën atë mbrojtje ku hyn edhe ndryshimi i Statutit". (Po aty, f. 610). Me një fjalë, dy Dhomat Legjislative nuk kishin të drejtën të bënin ndryshimin e kufirit veç e veç, por vetëm me mbledhjen e votave bashkërisht". Ibrahim Xhindi e quan me vend mbledhjen e përbashkët të të dyja Dhomave Legjislative, të cilat vetëm ato kishin të drejtë dhe jo të dyja Dhomat veç e veç, që të miratonin ndryshimin e Statutit.

Xh. Dino tha se sipas kryetarit të Parlamentit "Asambleja çdo herë mund të ndryshojë një pikë kufiri duke proceduar në bazë të artikullit 141 të Statutit. Më duket se kjo deklaratë, - vazhdoi ai, - është alarmante, mbasi ndryshimi duhet të bëhet vetëm këtë herë, meqenëse kanë mbetur vetëm këto dy pika për të përfunduar. Prandaj mos të alarmohemi. Kjo shtojcë është shumë e mirë". (Po aty, f. 610). Sipas Fiqiri Rusit, për një ndryshim kufiri nuk mjaftonte një autorizim i Asamblesë por duhej një ligj. Sipas Sali Vuçiternit, aty nuk flitej për një autorizim, por për një shtesë të nenit 2 të Statutit, prandaj e quante të drejtë shtojcën e nenit 2 ashtu siç e kishte formuluar komisioni.

Sikurse shihet, komisioni pranoi se kufiri mund të ndryshonte pa përcaktuar motivacionin, vetëm me kushtin që ai të miratohej

nga dy e treta e asamblastëve. Shumica e asamblastëve, të cilët tashmë dihet se ishin përkrahës të A. Zogut, e miratuan në parim ndryshimin e kufijve të Atdheut pa përcaktuar motivacionin.

ur shtojca e nenit 2 të statutit u vu në votim në dy Dhomat Legjislative nga 65 asamblastë (18 senatorë dhe 47 deputetë), në sallë ndodheshin 54 deputetë dhe senatorë. Prej tyre në favor të shtojcës së nenit 2 të Statutit votuan 43 asamblastë. Kundërshtuan haptas 8 asamblastë (Pjetër Shan Deda, Kol Mjeda, Kolec Deda, Ndrek Kiçi, Prenk Llosh Gjoni, Said Kalaja, Tef Gera, Zenel Mandiqi). Një asamblast abstenoj (Maliq Bushati), kurse 2 asamblastë kur filloi votimi u larguan nga salla (Dr. Loni Gjini, Syrja Pojani). Si rrjedhim, shtojca e Statutit u miratua me 43 vota, të cilët ishin dy e treta e numrit të përgjithshëm të asamblastëve dhe jo të asamblastëve të pranishëm. Pasi përfundoi votimi, kryetari Eshref Frashëri u paraqiti dy Dhomave Legjislative një mocion dërguar nga Myfit Libohova të formuluar në këtë mënyrë:

"Senati dhe Dhoma e Deputetëve të mbledhur së bashku, sot më 18 korrik 1925 për të biseduar mbi çështjen e kufijve shqiptaro-jugosllav, pranon në parim një shkëmbim toke midis dy shteteve dhe autorizon qeverinë të hyjë në marrëveshjet e duhura në përputhje me interesat e shtetit dhe të popullit shqiptar". (Poaty, f. 612). Më tej në mocion thuhej: "Përpara se të përfundohen (nënshkruhen - K.F.) këto marrëveshje, qeveria do t'ia paraqesë në sesion të vjeshtës në fillim secilës Dhomë veçanërisht për të marrë vendimet e tyre sipas dispozitave të artikullit 141 të Statutit dhe për të thirrur pastaj mbledhjen e Asamblesë Legjislative për vendim përfundimtar".

Marrëveshja shqiptaro-jugosllave

Duke patur parasysh rëndësinë kombëtare që kishte çështja e kufijve, Eshref Frashëri i kujtonte kryetarit të qeverisë (A. Zogut) se para se të hynte në marrëveshje me palën jugosllave, duhej të kërkonte autorizimin e dy Dhomave. (Po aty, fq. 620-621). Propozimi u pranua njëzëri. Këtë mocion, tani të miratuar, kryetari i dy Dhomave Legjislative ia paraqiti kryetarit të qeverisë të nesërmen, më 20 korrik 1925.

Më 5 gusht 1925 Komisioni Ndërkombëtar i Caktimit të Kufijve të Shqipërisë miratoi "raportin e Komitetit Teknik Gjeografik në lidhje me zgjidhjen që kishin gjetur me kompromis të dyja qeveritë për vijën kufitare në sektorët e Shën Naumit dhe të Vermoshit". Marrëveshja e arritur midis dy qeverive shkaktoi entuziazëm në Jugosllavi. I ngarkuari me Punë i Shqipërisë në Beograd, Dr. Gjergj Pekmezi, në relacionin që i drejtonte qeverisë shqiptare në 10 gusht shkruante se shtypi i Beogradit e konsideronte marrëveshjen si një fitore të Jugosllavisë, mbasi, sipas saj, "manastiri i Shën Naumit dhe Vermoshi iu dhanë përfundimisht Jugosllavisë prej Konferencës së Ambasadorëve. Si shpërblim, shkruan Shtypi, Shqipërisë iu dha fshati Peskopi në vend të Shën Naumit, kurse në Vermosh do të bëhet një

rektifikim në favor të Shqipërisë. Gazetat e Beogradit, - shton Gj. Pekmezi, - e paraqesin këtë ngjarje politike si një ngadhënjim të diplomacisë jugosllave". (Po aty, f. 624).

Kryeministri Nikolla Pashiç ngeli i pakënaqur, ndoshta i zhgënjyer, ngase lakmonte që Jugosllavia të merrte më tepër seç mori. Por më vonë, siç duket nën presionin e aleatëve të tij të mëdhenj, u pajtua me marrëveshjen.

Emigrantët politikë shqiptarë qenë të parët që protestuan kundër lëshimit të Shën Naumit dhe të Vermoshit në favor të Jugosllavisë. Ndër to duhet veçuar protesta që Fan Noli, ish-kryeministri i Shqipërisë, i dërgoi Lidhjes së Kombeve më 18 gusht 1925. Në peticion protestohet kundër marrëveshjes së lidhur midis qeverive shqiptare dhe jugosllave, e cila u ratifikua nga Konferenca e Ambasadorëve për lëshimin Jugosllavisë të rrethit të malit Vermosh dhe të manastirit të Shën Naumit kundrejt një rregullimi të vogël të kufijve jugosllavo-shqiptare në favor të Shqipërisë. Sipas Fan Nolit, marrëveshja nuk do t'i zbuste marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Përkundrazi, sapo të ndryshonte qeveria në Tiranë, grindjet midis shqiptarëve dhe jugosllavëve do të rishfaqeshin përsëri. Pakënaqësia e shqiptarëve, vazhdon Noli, rridhte ngase Shqipëria po i jepte Jugosllavisë territore të cilat asaj i qenë njohur nga Konferenca e Ambasadorëve. Më tej Fan Noli shpjegonte se Beogradi e përkrahu Ahmet Zogun të rimerrte pushtetin, me kusht që ky t'ia shpërblente me ato territore që ajo nuk i siguroi dot me Konferencën e Paqes.

Në qarqet diplomatike të Perëndimit bëri përshtypje të thellë fakti se si Konferenca e Ambasadorëve në Paris shkeli me këmbë vendimin që ajo vetë kishte marrë disa herë për Shën Naumin dhe Vermoshin në favor të Shqipërisë. Sipas këtyre zërave,

Athina u pendua që i kishte lëshuar Shqipërisë 12 fshatrat e zonës kufitare të Bilishtit dhe nuk kishte ndjekur shembullin e Jugosllavisë, e cila me këmbënguljen e saj e fitoi Shën Naumin dhe pyllin e Vermoshit.

Pas disa javësh, më 28 shtator 1925, Ahmet Zogu si president e ndryshoi përbërjen e qeverisë që kryesonte si kryeministër. Vendin e Myfit Libohovës si zv.ministër i Punëve të Jashtme, e zuri Hysen Vrioni, atë të Ceno bej Kryeziut si ministër i Punëve të Brendshme e zuri Musa Juka, vendin e Petro Pogës si ministër i Drejtësisë e mori Milto Tutulani, vendin e Myfit Libohovës si ministër i Financave e zuri Sulejman Starova.



Pandeli Evangjeli

Ndryshime u bënë edhe në kryesinë e Dhomave Legjislative. Kryetar i Senatit në vend të Eshref Frashërit u ngarkua Pandeli Evangjeli, kurse kryetar i Dhomës së Deputetëve disa ditë më vonë u ngarkua Koço Kota. Ndërkohë, në Paris vazhdonin bisedimet midis delegatëve shqiptarë dhe jugosllavë. Mehdi Frashëri kishte kërkuar nga pala jugosllave: a) Zgjerimin e zonës së Piskupisë, duke përfshirë gjithë lartësitë strategjike brenda në kufirin shqiptar e duke ia lënë Jugosllavisë vetëm "binanë" (ndërtesën - K.F.) e Shën

Naumit. b) Në anën e Velipojës kishte kërkuar gjithë kurrizin e Skrabatushës me gjithë karakollin e vjetër të Turqisë, që ndodhet në majë, ashtu dhe kullotën e Libovicës me gjithë rrugën që vete në Lumrajë. Ai kishte kërkuar gjithashtu "majën e

vogël me gjithë dy liqene edhe një rrugë, që vete në Lumrajë, nga ana e Perëndimit, si dhe katundin Skenjë". (Po aty, f. 636).

Por, kërkesën e palës shqiptare, pala jugosllave nuk e pranoi. Sipas delegatit jugosllav, Beogradi përveç zonës së Piskupisë në zonën e Shën Naumit dhe një pjese të Libovicës, në zonën e Vermoshit, të cilat në fakt i takonin Shqipërisë - nuk jepte gjë tjetër. Komisioni i Kufijve duke parë se dy delegacionet nuk ranë në marrëveshje, i kërkoi udhëzime Konferencës së Ambasadorëve. Si përgjigje, Konferenca e Ambasadorëve, duket nën ndikimin e Francës, aleate e Jugosllavisë, e caktoi vetë vijën e kufirit, duke i lënë Shqipërisë në sektorin e Shën Naumit "kodrat e Shën Naumit dhe duke caktuar si kufij vijën në kuotat nr.961 - 965 - 807 - 862 me gjithë karakollin e Serbisë dhe kishën e Ajazmës", kurse në sektorin e Vermoshit "kullotat e Libovicës, dy shtëpi të fshatit Grençar, rrugën e Lumrajës, Majën e vogël me gjithë liqenet, kurrizin e Velipojës me gjithë karakollin e vjetër të Turqisë". (Po aty, f. 636), të cilat gjithashtu, në bazë të Protokollit të Fuqive të Mëdha të vitit 1913, i takonin Shqipërisë.

Vija e re e kufirit e Konferencës së Ambasadorëve nuk ishte vendim, por propozim. Qeveria e Tiranës e pranoi si vendim dhe ia përcolli për miratim Asamblesë të të dyja Dhomave Legjislative. Këtë vijë kufiri, thuhej në shkresë, qeveria shqiptare e mëparshme e pranoi, me kusht që të miratohej nga Parlamenti. Prandaj, përfundonte relacioni, qeveria lutej që ajo të miratohej me shpejtësi nga të dyja Dhomat Legjislative. Në të vërtetë, Parlamenti kishte autorizuar qeverinë shqiptare që të lidhte një marrëveshje me Beogradin dhe jo ndërhyrjen e Konferencës së Ambasadorëve. Përkundrazi, qeveria shqiptare mbasi nuk e kishte realizuar marrëveshjen, e kishte zëvendësuar

me propozimin e Konferencës së Ambasadorëve. Për më tepër, qeveria shqiptare e kishte konsideruar pa të drejtë propozimin si "vendim". Kjo sjellje e qeverisë shqiptare shkaktoi debat në mbledhjen plenare të të dyja Dhomave Legjislative.

Për të ratifikuar përmbajtjen e "propozimit" që kishte dërguar Konferenca e Ambasadorëve mbi kufijtë e Shqipërisë, Asambleja e dy Dhomave Legjislative u mblodh më 14 tetor 1925, nën kryesinë e Pandeli Evangjelit. Rendi i ditës ishte formuluar në këtë mënyrë: "Bisedim mbi ratifikimin e kufirit në anë të Shën Naumit e në perëndim të Velipojës e të përroit Voçopotok me Jugosllavinë".

Në fillim fjalën e mori Eshref Frashëri, kryetari i mëparshëm i Asamblesë. Ai deklaroi se e pranonte "vendimin" e Konferencës së Ambasadorëve, ndonëse ai nuk pajtohej me vendimin që kishte marrë më parë Asambleja, e cila kishte kërkuar një marrëveshje dypalëshe shqiptaro-jugosllave.

Mihal Kaso tha: "Meqenëse ky është një vendim i Konferencës së Ambasadorëve, ne nuk kemi të drejtë të kundërshtojmë, sepse ajo e ka dhënë brenda kompetencave që ka. Si rrjedhim, Asambleja nuk ka të drejtë ta kundërshtojë, as të drejtë që të diktojë nëse e pranon ose jo, mbasi është vetvetiu i pranuar". (Po aty, f. 637).

Xhafer Ypi kërkoi që delegati shqiptar Mehdi Frashëri të jepte shpjegime rreth këtij vendimi, por disa nga salla e kundërshtuan, mbasi sipas tyre, shpjegimet ishin dhënë në relacionin e qeverisë.

Selaudin Blloshmi shfaqti mendimin se ishte gati ta miratonte "vendimin" e Konferencës së Ambasadorëve nëse qeveria ishte e

bindur se me miratimin e vendimit të saj do t'i jepej fund zhurmës që bënin kundërshtarët se me këtë marrëveshje cenoheshin interesat kombëtare të Shqipërisë, dhe, e dyta, nëse me këtë marrëveshje zgjidhej përfundimisht çështja e kufirit shqiptaro-jugosllav. Mehdi Frashëri u përgjigj se me miratimin e këtij vendimi çështja e kufirit shqiptaro-jugosllav nuk do të ekzistonte më.

Sipas Sali Vuçiternit, Asambleja i pati dhënë autorizim qeverisë shqiptare të hynte në marrëveshje me qeverinë jugosllave, kurse tani po shihej se marrëveshja nuk ishte arritur dhe se tani Asambleja ka para saj një "vendim" të Konferencës. "Prandaj fjalët tona, - tha ai, - tani janë të kota, mbasi kemi të bëjmë me një vendim të Konferencës së Ambasadorëve. Nuk mbetej gjë tjetër, - përfundoi ai, - veçse që ai vendim të miratohej".

Ndrek Kiçi debatoi me Mehdi Frashërin, i cili pohoi se me këtë vendim merrnin fund propagandat. Nëse me propagandë M. Frashëri aludonte për Shkodrën, nënvizoi Ndrek Kiçi, e kishte gabim. Shkodra, tha ai, nuk bën propagandë, por është e prekur nga ky vendim. "Shkodra, - nënvizoi ai, - asht ajo që asht vra tash 400 vjet me shkja e me turq e ka luftue për pavarësinë e Shqipnis. Shkodra dhe populli i saj asht një popull i ndershëm e patriot, që nuk asht kursye kurrë për komb e atdhe. Shkodra nuk ban propaganda, po shka do qi të ketë folë e ka ba prej hallit e friget të madhe. Kur ndigjohet se po ndryshohet Statuti, kujtdo i hyen frika, nuk a ba, po ka mujt me u ba". (Po aty, f. 639).

Për ta zbutur tensionin që ngjalli në sallë termi "vendim" i shprehur prej tij, i cili në të vërtetë ishte sugjerim, Mehdi Frashëri shpjegoi se "vendimi i Konferencës së Ambasadorëve është një vendim si arbitër dhe jo si gjykatore. Ajo këshillon të

merremi vesh dhe ajo dëgjoji bisedimet midis të dyja palëve. Ajo tha: meqenëse kemi ndeshur në pengime, po ju hyj në mes dhe hoqi një vijë tranzancionale. Pra, ky vendim i Konferencës nuk është një vendim si gjykatore, por si arbitër. Këtë konferenca jua komunikoi të dyja qeverive të interesuara. Ajo kërkon përgjigje brenda 15 ditëve, nëse dy qeveritë e pranojnë ose jo. Pra ju do të miratoni një vendim jo të një gjykatoreje, por të një arbitri. Këtë vendim e pranoi qeveria jugosllave. Prandaj ju, - ai iu drejtua asamblistëve - veproni si të doni". (Po aty, f. 640).

Pyetjes që iu drejtua Mehdi Frashërit nëse sugjerimin e Konferencës së Ambasadorëve e pranoi ose jo Parlamenti jugosllav, ai iu përgjigj se nuk kishte dijeni. Eshref Frashëri thumbi se ai arbitër që "më ka gjykuar herën e parë po më gjykon edhe herën e dytë, i cili herën e parë më preu një këmbë e një dorë tani po më pret edhe dorën tjetër. Këtë vendim do ta pranoj nga zori". Eshref Frashëri kërkoi që dy Dhomat Legjislative të miratonin marrëveshjen për të cilën ishte ngarkuar qeveria dhe jo sugjerimin e Konferencës së Ambasadorëve. Mehdi Frashëri shtoi se nuk mund të thuhet se sugjerimi i Konferencës së Ambasadorëve nuk ishte një marrëveshje. "Ne treguam faktet që kanë ngjarë në Konferencën e Ambasadorëve. Mbasi ndodhi një mosmarrëveshje midis dy qeverive, Konferenca hyri në mes si arbitër dhe caktoi një vijë tranzicionale kufiri. Ne, - tha ai, - nuk jemi të detyruar ta pranojmë këtë marrëveshje. Megjithatë, Konferenca e Ambasadorëve moralisht ka një prestigj, pra marrëveshja gjithnjë qëndron.

Xhafer Ypi gjeti një zgjidhje origjinale. Asambleja, - tha ai, - nuk është e detyruar ta pranojë sugjerimin e Konferencës së Ambasadorëve. Por ne duhet ta konsiderojmë sikur është

vendim, prandaj duhet ta pranojmë. (Po aty, f. 640). Xhemil Dino propozoi për miratim këtë mocion: "Asambleja Legjislative pranon ratifikimin e vendimit në mënyrë arbitri të Konferencës së Ambasadorëve". Mehdi Frashëri paraqiti një mocion të ndryshëm: "Të dyja Dhomat të mbledhura së bashku, miratojnë vendimin e pranuar nga qeveria dhe të propozuar nga Konferenca e Ambasadorëve". (Po aty, f. 641). Xhemil Dino paraqiti një mocion të tretë: "Të dyja Dhomat të mbledhura së bashku ratifikojnë vendimin arbitrar të pranuar nga të dyja qeveritë".

Eshref Frashëri tha: "Pse lozim me fjalë? Këshilla e të Madhit është urdhër dhe Këshilli i Ambasadorëve për të mos rrëzuar dinjitetin e tij, nuk thotë se dha një vendim përfundimtar, por një vendim arbitri. Për mua është urdhër dhe e pranoj si urdhër".



Musa Juka

Musa Juka e mbrojti tezën e qeverisë. "Meqenëse, - tha ai, - dy qeveritë (shqiptare dhe jugosllave) nuk arritën të merreshin vesh, për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre ndërhyri Konferenca e Ambasadorëve, me qëllim që të dy qeveritë të binin në marrëveshje. Veç kësaj, nga kjo marrëveshje shteti jonë nuk ka ndonjë dëm, përkundrazi ka dobi". Meqenëse sugjerimin e Konferencës së Ambasadorëve e ka miratuar qeveria shqiptare, ai kërkoi që Asambleja Legjislative ta miratonte si

marrëveshje dhe jo si sugjerim. Qëllimi im, - tha Eshref Frashëri, - është të siguroj ardhmërinë e Shqipërisë. Me këtë ai donte t'ia mbyllte rrugën ndryshimeve të tjera të kufirit. E kishte fjalën për zërat që qarkullonin se Greqia e inkurajuar nga kjo marrëveshje do të bënte përcapje për të riparë kufirin e jugut. Në përgjigjen e tij Mehdi Frashëri tha se ardhmëria e Shqipërisë nuk ka lidhje me këtë çështje. Çështjet që kanë gjetur zgjidhje me kohë nuk kanë të bëjnë hiç me problemin e Shën Naumit dhe të Vermoshit. Kjo çështje nuk mund të bëhet shkak për të rihapur një çështje që ka gjetur zgjidhje përfundimtare. Për shembull, çështja e kufirit me qeverinë greke ka marrë, - tha ai, - formë përfundimtare me kartë, me protokoll. Shteti grek nuk mund ta përdorë këtë si pretekst për të kërkuar rishikimin e kufirit". (Po aty, f. 642).

Kjo ishte, - tha ai, - një pjesë e kufirit, e cila ishte në konflikt mbasi qeveria jugosllave nuk e kishte pranuar. (Në të vërtetë, edhe në këto dy sektorë në fillim kufiri qe caktuar përfundimisht dhe se konflikti lindi pas kundërshtimit të Jugosllavisë. Eshref Frashëri kishte të drejtë kur thoshte se ku ndryshim kufiri mund t'i jepte rast Greqisë të kërkonte korrigjimin e kufirit në jug, pavarësisht se edhe këtu kufiri ishte vendosur përfundimisht).

Selaudin Blloshmi tha se po bëheshin lojëra fjalësh dhe se ardhmëria nuk sigurohej me fjalë. "Këtu po bisedohet çështja e kufirit me Jugosllavinë. Nëse lindin çështje të tjera të kufirit, atëherë do t'i bisedojmë, por jo tani... Jemi shumë të dobët, - përfundoi ai. - Po të ishim të fortë nuk do ta pranonim. Prandaj mos ta përziejmë çështjen duke thënë se është një vendim i Këshillit të Ambasadorëve... Ne kërkuam arbitrin dhe ajo na këshilloi". (Po aty, f. 643).

Mehdi Frashëri e kundërshtoi pohimin e S. Blloshmit, se qeveria shqiptare kërkoj arbitrazhin e Konferencës së Ambasadorëve. "Jo, zotërinj, - tha ai, - qeveria nuk e kërkoj këtë ndërmjetësim. Atë e kërkoj Komisioni i Kufijve kur pa se të dy qeveritë nuk u morën vesh midis tyre. Qeveria shqiptare, - vazhdoi ai, - ka kërkuar zbatimin e vendimit që kishte dhënë më parë Konferenca e Ambasadorëve".

Fiqiri Rusi u pajtua me vërejtjen e Eshref Frashërit. Ai pyeti: "Ç'nevojë kishim të ndryshonim nenin 2 të statutit, kur rezulton çiltazi se Konferenca e Ambasadorëve hyri si arbitër dhe ua kishte dhënë pëlqimin dy qeverive të interesuara? Ky është një vendim i detyrueshëm, të cilin duhet ta ratifikojmë të shtyrë nga një nevojë.

Eshref Frashëri duke rimarë fjalën përsëri tha se këtë radhë Konferenca e Ambasadorëve prishi vendimin e parë të saj, mori qysqinë e fshiu vendimin e parë, mori qysqinë e bëri një vendim të dytë që të mos derdhej gjak në Ballkan.

S. Vuçiterni i ra shkurt: "Përderisa qeveria e ka pranuar këtë zgjidhje të kufirit, përse mos ta pranojnë asamblistët?" S. Blloshmi kërkoj të vihej në votë kërkesa e qeverisë. Milto Tutulani, ministri i Drejtësisë vuri në dukje dy prirjet e asamblistëve. Një palë e trajton çështjen nga pikëpamja juridike, kurse disa të tjerë kërkojnë ratifikimin e propozimit të Konferencës të Ambasadorëve. Ai mendoi se meqenëse qeveria e humbi shpresën për të arritur një marrëveshje me qeverinë jugosllave, nuk mbetej gjë tjetër veçse të miratohej "vendimi" i Konferencës së Ambasadorëve. Kuptohej se me këtë sugjerim Konferenca kërkonte një zgjidhje, në një "modus viventi", një

mënyrë që të anulonte vendimin e saj të mëparshëm. (Po aty, f. 643).

Eshref Frashëri duke ndërhyrë përsëri, tha: "Qeveria po luan me fjalë. Po përdoret fjala shkëmbim. Unë fjalën shkëmbim nuk e votoj". Kristo Floqi kërkoi që të mos përdorej fjala "influencuar" nga Konferenca e Ambasadorëve. "Është tepër e fortë - tha ai - dhe propozoj të ndërrohet. Pastaj kush na siguron, në qoftë se qeveria nuk i përmbahet këtyre kushteve, a thua Evropa do të bëjë një demonstratë navale si në Ulqin (si në vitin 1880 - K.F.)?".

Gjergj Çako tha: "Ne nuk mundemi t'i japim këshilla Konferencës së Ambasadorëve edhe sikur kjo marrëveshje të jetë e influencuar prej saj, atë e shajmë kur themi e influencuar. Prandaj, të hiqet ajo fjalë".

Ferit Vokopola shfaqti mendimin që vendimi të formulohej në këtë mënyrë: "Asambleja Legjislative, në bazë të shkresës së qeverisë edhe të shpjegimeve të dhëna nga Z. Mehdi Frashëri, delegati fuqiptotë i kufijve, miratoi me vota unanime marrëveshjen e bërë midis qeverisë sonë dhe asaj të Jugosllavisë, sipas propozimit transaksional të Konferencës së Ambasadorëve, i cili i përket ratifikimit të kufirit të veriut në një pjesë të Velipojës e të jugut drejt Shën Naumit". Milto Tutulani deklaroi se me këtë njoftim bashkohet edhe qeveria. Propozimi i Ferit Vokopolës u vu në votim dhe u pranua njëzëri.

Po atë ditë, më 14 tetor 1925, u hartuan dy shkresa nga kryetarët e dy Dhomave Legjislative, Koço Kota dhe Pandeli Evangjeli, të cilat deklarorin miratimin e rezolutës veç e veç prej tyre. Të nesërmen, më 15 tetor Pandeli Evangjeli në emër të Asamblesë Legjislative njoftoi qeverinë shqiptare se Asambleja e miratoi me

vota unanime "marrëveshjen e bërë midis qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave, sipas propozimit transaksional të Konferencës së Ambasadorëve, e cila i përket ratifikimit të kufirit të Veriut në një pjesë të Velipojës e të Jugut drejt Shën Naumit". (Po aty, f. 648).

Është për të shënuar se në këtë njoftim flitet për miratimin e marrëveshjes së lidhur midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë për zgjidhjen e çështjes së kufirit, kurse në Asamblenë Legjislative u fol vetëm për sugjerimin e Konferencës së Ambasadorëve. Veç kësaj, në rezolutën e miratuar nga Asambleja Kushtetuese flitet për caktimin e kufirit "transaksional" në sektorin e Shën Naumit dhe në atë të Vermoshit, pa përmendur se kemi të bëjmë me shkëmbim terriresh.

Vetëm më 19 tetor 1925 shefi i Zyrës së Shtypit në Tiranë, Teki Selenica u përcolli mediave të asaj kohe komunikatën që vijon:

"Ju njoftojmë se të dy Dhomat Legjislative të mbledhura në formë Asambleje, mbasi dëgjuan shpjegimet e Z. Mehdi Frashëri miratuan njëzëri marrëveshjen e banum midis qeverisë sonë dhe asaj të Jugosllavisë, mbas propozimit transaksional, të Konferencës Ambasadoriale mbi ratifikimin e kufijve, e cila asht plotësisht në favorin e Republikës sonë. Veç ndërtesës së Manastirit të Shën Naumit dhe përroit Voçopotok, qeveria shqiptare as Vermoshin, as Velipojën, as një pëllëmbë tokë nuk humbet, por përkundrazi kundrejt ndërtesës së Shën Naumit, merr katundin Peshkopi, fushën e Çërravës, kishën e Ajazmës dhe kodrat strategjike të Shën Naumit Nr. 961, 965-807-862 me gjithë karakollin e Serbisë dhe fiton një tokë prej 22 kilometrash katrore duke larguar kufirin dhe duke siguruar rrugën Pogradec-Korçë. Në Vermosh kundrejt përroit Voçopotok, merr kullotën e

Libovicës, dy shtëpi të katundit Grenca, udhën e Lumrajës, Majën e Vogël me gjithë liqenet, kurrizin e Velipojës, me gjithë karakollin e vjetër të Turqisë dhe gjithë vargun e malit, duke zgjeruar kufirin 25 kilometra". (Po aty, f. 649).

Pas gjithë këtij kalvari debatesh, kufiri shqiptaro-jugosllav u përcaktua përfundimisht vitin e ardhshëm me protokollin dypalësh të 26 korrikut 1926. Akti final i përcaktimit të kufijve të Shqipërisë u regjistrua në Lidhjen e Kombeve më 30 korrik 1926.

PERFUNDIME

Në mbyllje është vendi të bëjmë disa vërejtje rreth këtij kalvari. Nga bisedimet e zhvilluara në mbledhjet plenare të Asamblesë vihen re përpjekjet për të fshehur dy komponentët kryesorë të çështjes kaq të debatuar të Shën Naumit dhe të Vermoshit.

E para, asnjëri nga asamblistët nuk vuri në dukje se lëshimi i Manastirit të Shën Naumit dhe i Velipojës së Vermoshit ishte një dhuratë që Ahmet Zogu në emër të Shqipërisë i jepte Jugosllavisë dhe jo një shkëmbim terriroresh siç pretendonte qeveria shqiptare që gjoja Jugosllavia ia jepte për kompensim Shqipërisë. Kjo për arsye se terrioret që i jepeshin për këmbim Jugosllavisë, Fuqitë e Mëdha, sikurse u tha, ia kishin njohur Shqipërisë që më 1913. Këtë e dëshmon vetë komunikata e Zyrës Shqiptare të Shtypit, ku thuhet se Jugosllavia ia ktheu Shqipërisë terrioret: në sektorin e Shën Naumit deri te karakolli serb, kurse në sektorin e Vermoshit deri në karakollin e vjetër turk.

E dyta, për të justifikuar dhuratën që Zogu i jepte Jugosllavisë, disa deputetë dhe senatorë bënë orvatje për ta paraqitur propozimin e Konferencës së Ambasadorëve si një

"vendim", disa të tjerë si "sugjerim" por me vlerën e një vendimi, kurse qeveria e vlerësoi si një marrëveshje dypalëshe shqiptaro-jugosllave. Pavarësisht nga këto interpretime, ajo që tronditi opinionin shqiptar ishte ndryshimi i kufirit pa ndonjë forcë madhore.

Miratimi njëzëri i propozimit të Konferencës së Ambasadorëve nga të dyja Dhomat Legjislative, dëshmoi se deputetët dhe senatorët, të cilët në fakt qenë emëruar nga A. Zogu, pra nuk qenë zgjedhur me votë të lirë nga popullsia, nuk ishin të pavarur. Bindja që shprehu Mehdi Frashëri në mbledhjet plenare të dy Dhomave Legjislative se me përfundimin e marrëveshjes shqiptaro-jugosllave do të merrnin fund akuzat e kundërshtarëve të regjimit rreth çështjes së Shën Naumit dhe të Vermoshit, - ishte një demagogji.

Protestat filluan që kur çështja ishte në ditët kur bisedohej marrëveshja shqiptaro-jugosllave për çështjen e Manastirit të Shën Naumit dhe Velipojës së Vermoshit. Meqenëse me vendosjen e autoritetit të Ahmet Zogut, kritikën kundër politikës së tij dënoheshin nga organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, protestat kundër lëshimit të manastirit të

Shën Naumit dhe të Velipojës së Vermoshit u shprehën nga shqiptarët e mërguar jashtë Shqipërisë. Zëdhënësi kryesor i këtyre protestave u bë Fan Noli, ish-kryeministri demokrat i Shqipërisë tani kryetari i Komitetit Nacional Revolucionar (KO-NA-RE), me qendër në Vjenë. Në protestën që ai i drejtoi Lidhjes së Kombeve, thuhej prerazi se marrëveshja nuk do t'i zbuste marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Përkundrazi, sapo të ndryshonte qeveria në Tiranë, grindjet midis shqiptarëve dhe jugosllavëve do të rishfaqeshin përsëri. Pakënaqësia e shqiptarëve, vazhdonte Noli, rridhte ngase Shqipëria po i jepe Jugosllavisë territore, të cilat i kanë qenë njohur Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve. Më tej Fan Noli shpjegonte se Beogradi e përkrahte Ahmet Zogun të rimerrte pushtetin, me kusht që ky t'ia shpërblente me ato territore që ajo nuk i siguronte dot me Konferencën e Paqes.

Në qarqet diplomatike të Perëndimit bëri përshtypje fakti se si Konferenca e Ambasadorëve në Paris shkeli me këmbët e saj vendimin që ajo vetë kishte marrë disa herë për Shën Naumin dhe për Vermoshin në favor të Shqipërisë. Sipas këtyre zërave, Athina u pendua që i kishte lëshuar Shqipërisë 14 fshatrat e zonës kufitare të Bilishtit dhe nuk kishte ndjekur shembullin e Jugosllavisë, e cila me këmbënguljen e saj Shqipëria e lëshoi Shën Naumin dhe pyllin e Vermoshit.

Në të vërtetë, ndodhi ajo që parashihnin opozitarët shqiptarë se lëshimi i Shën Naumit dhe i Velipojës së Vermoshit do të ngacmonte qeveritarët e Athinës për të kërkuar dhe ata ndryshimin e kufirit shqiptaro-grek.

Një nga gazetatat kryesore të Athinës, e përditshmja "Vradhini" shkruante më 2 nëntor 1925 një artikull editorial me titullin "Ndërsa neve (grekët - K.F.) japim, serbët dinë të marrin". Në këtë artikull bëhej aluzion për Greqinë, e cila ia lëshoi Shqipërisë zonën prej 14 katundesh në kufi me Bilishtin. Në artikull thuhej ndër të tjera:

"Më datë 10 gusht 1925 gazeta "Vreme" e Beogradit i thurte elozh diplomacisë serbe, se ajo mundi t'i aneksonte manastirin e Shën Naumit Serbisë dhe e karakterizonte këtë sukses si një fitore të madhe diplomatike... Manastiri i Shën Naumit si dhe rrethi i malit Vermosh u përmbloodhën në kufijtë e Shqipërisë, në mënyrë që u përmbloodhën edhe 14 fshatrat e ditura të Greqisë. Po ndërsa neve shpejtua t'ia lëshojmë këto Shqipërisë, që të sigurojmë gjoja miqësinë e saj dhe relacione të mira fqinjësie me të, serbët më praktikë se neve refuzuan dhe në asnjë mënyrë nuk pranuan pa shkëmbim dhe pa u marrë parasysh interesat e tyre të vërteta... Që prej atij çasti duhet të pranohet se filloi fitorja e diplomacisë serbe, se iu dha asaj rasti që të përdorte çdo mjet që kishte në dispozicion që të shtrëngonte Shqipërinë të përulej... Konferenca e Ambasadorëve në maj të këtij viti dha vendim me të cilin Manastiri i Shën Naumit gjer në Çalësi i jepej Shqipërisë; por edhe këtë vendim serbët e kundërshtuan duke deklaruar se vetëm atëherë do t'i lëshojnë këto vende kur edhe Italia do të lëshojë ishullin e Sazanit... Cilat ishin arsyet që e shtrënguan Shqipërinë që të pranonte lëshim tokash, që i ishin dhënë asaj aq zyrtarisht? - pyet

autori. -Në këtë pikërisht konsiston suksesi i diplomacisë serbe, që me të drejtë shtypi serb e karakterizon si fitore të madhe. Mënyra e veprimit të saj është një mësim didaktik për neve, që nuk ndruajmë për të siguruar gjoja favorin e Evropës, të sakrifikojmë me aq mendjelehtësi tokat e fituara me gjakun e fëmijëve tanë. Dhe sikur të paktën me këtë sakrificë të sigurohej, jo miqësia e Shqipërisë, e cila nuk meritonte për asnjë shpërblim, por qenia e mëse 180 mijë grekëve (siç!) do të kishte një arsye të justifikuar të këtij vendimi të shpejtuar, mjerisht as ajo nuk u arrit. Përkundrazi Serbia me këtë qëndrim të saj, duke patur në duart e saj këtë fitim pozitiv tokësor, arriti sigurisht qëllimin e përkrahjes së interesave të saj në Shqipëri, ashtu si ajo i kupton ato dhe të cilat nuk e lënë aspak tonat të pacenuara... Në këto pyetje sigurisht duhet të përgjigjen ata (qeveritarë) që e patën në dorë çështjen e lëshimit të 14 fshatrave dhe atyre që erdhën më vonë, dhe jo qeveritarët e sotëm, të cilët janë viktima". (Po aty, f. 650).

Kundrejt kritikave që i drejtoheshin Ahmet Zogut ai vazhdoi ta bënte veshin e shurdhër. Sa qe gjallë ai nuk u dha asnjë përgjigje akuzave që i drejtoheshin se kishte shkelur për interesa personale integritetin tokësor të Shqipërisë. Ai i trajtoi çështjen e Shën Naumit dhe të Vermoshit vetëm në të ashtuquajturat "Kujtime" që ai i ka diktuar kolonel Hysen Selmanit kur ishte në mërgim, të cilat, siç u tha, u botuan vitet e fundit me titull: "Nga notimet e Zogut I mbretit të Shqiptarëve", Tiranë 2008.

Për të mënjeluar reagimin popullor nga ky akt antikombëtar, A. Zogu e ul vlerën e Manastirit deri në atë masë sa e quan një "ndërtesë" të braktisur. Veç kësaj, ai e shtrembëron sugjerimin për marrëveshje dypalëshe të Konferencës së Ambasadorëve, duke e quajtur atë "vendim". "Konferenca e Ambasadorëve, duke parë kundërshtimin jugosllav për këtë manastir, - pohon A. Zogu, - i drejtohej qeverisë shqiptare me lutje që ta rregullonin në mes të dy shteteve këtë çështje sipas shpjegimeve që i jepte Mehdi Frashëri ... duke i treguar se Republikës shqiptare i kishte mbetur vetëm ndërtesa e Manastirit të Shën Naumit me një distancë prej 750 metrash tokë, e jo tjetër". (Nga notimet e Zogut, etj, f. 187). Ai thotë gjithashtu: "Këmbëngulja e Jugosllavisë për këtë manastir ishte dhe dëshira e Lidhjes së Kombeve (siç!), për një gjë kaq të lehtë e për mos t'i dhënë shkak ndonjë ngatërrese që nuk sjell asnjë dobi për katër mure të Manastirit të Shën Naumit, ku as ideali kombëtar nuk cenohej, as kishte ndonjë rëndësi morale apo strategjike, apo vlerë ekonomike". (Po aty, f. 187).

A. Zogu nuk thotë gjithashtu të vërtetën kur shkruan se Lidhja e Kombeve i rekomandoi qeverisë shqiptare që të hynte në bisedime me palën jugosllave për lëshimin e Shën Naumit. Përkundrazi, që më 27 prill 1925 Lidhja e Kombeve njoftoi se në përfundim të trajtimit të çështjes edhe nga Dhoma e Drejtësisë Ndërkombëtare (Gjykatorja e Hagës), Manastiri i Shën Naumit i takonte Shqipërisë. Propozimi i Lidhjes së Kombeve nuk përmbante ndonjë porosi për

marrëveshjen midis Tiranës dhe Beogradit në lidhje me këtë çështje. Edhe ultimatumit, i cili sipas A. Zogut, gjoja Lidhja e Kombeve i dërgoi palës shqiptare, se po të mos merrej vesh me qeverinë jugosllave, Lidhja do ta pezullonte komisionin e posaçëm dhe do ta përcaktonte ajo vetë vijën përfundimtare të kufirit - nuk është i vërtetë.

Nga ana e vet, Mehdi Frashëri shkruan se më 28 korrik 1925 përfaqësuesi shqiptar (Mehdi Frashëri) dhe ai jugosllav (Spallaikoviç) arritën në marrëveshje për të ndryshuar kufirin në jug të liqenit të Ohrit, për t'ia lënë manastirin e Shën Naumit Jugosllavisë. Këtë lëshim, ai e justifikon duke ulur tej mase vlerën e manastirit. Ai shkruan se "Rrethi i Shën Naumit që lëshonte Shqipëria është një copë tokë me diametër 500 m". Mehdi Frashëri shton se këtë territor po e shfrytëzonin refugjatët antizogistë duke e paraqitur si tradhti. Në të vërtetë, theksonte ai, "tundej mali për një mi". (M. Frashëri, Kujtime, f. 204). Gjithë kjo zhurmë bëhej, sipas tij, "nga disa ortodoksë të rrethit të Korçës, të cilët i jepnin Shën Naumit një rëndësi fetare". Pastaj shton se: "Me këtë marrëveshje, çështja e kufijve të Shqipërisë, e cila kishte mbetur e varur (pezull) që nga viti 1913, për 13 vjet rresht, merrte formën definitive dhe ky caktim në politikën ndërkombëtare merrte një zgjidhje të favorshme dhe qetësi-prurëse për Shqipërinë". (Po aty, f. 205).

Argumenti që sillte Mehdi Frashëri për përfitimin që pati Shqipëria nga ky "shkëmbim" ishte absurd. Në të vërtetë, kritikën ndaj regjimit të Zogut për lëshimet në favor të

Jugosllavisë të Manastirit të Shën Naumit dhe të një sektori të Vermoshit jo vetëm nuk u zbutën, por u ndezën edhe më tepër. Madje, këto kritika historianët objektivë i vazhdojnë edhe në ditët tona. Është i qartë se ky cedim terriroresh shqiptare nuk ndodhi për forcë madhore - pra për faj të Shqipërisë. Veç kësaj, ndryshimi i kufirit cenonte një varg vendimesh të mëparshme, që kishin marrë Fuqitë e Mëdha, që të gjitha në favor të Shqipërisë. Më në fund, këtë lëshim, pavarësisht nga sipërfaqja e kufizuar e territorit, A. Zogu e nënshkroi për përfitime personale - për të marrë pushtetin në Shqipëri me ndihmën financiare dhe ushtarake të qeverisë jugosllave. Këtë akt përkrahësit zogistë mund ta cilësojnë si të duan. Një territor që i ishte njohur shtetit shqiptar - siç ishte sovraniteti mbi Manastirin e Shën Naumit dhe mbi krejt Vermoshin - pavarësisht nga shtojcat tinzare të kushtetutës, t'i dhurohej një shteti tjetër vetëm se prej tij A. Zogu pati përfitime personale, ishte pa dyshim një cenim i integritetit kombëtar të shtetit shqiptar, pra një faj i rëndë ndaj atdheut, ndaj kombit.



Kristo Frashëri lindi më 17 dhjetor 1920 në Stamboll, Turqi dhe është një historian shqiptar.

Kristo Frashëri është djali i parë i patriotit dhe rilindasit Anastas Frashëri dhe i Evdhoksi Tole-Ogrenit dhe rrjedh kështu prej njëres nga dinastitë e familjeve të Frashërit. I pagëzuar në kishën e Shën Triadhës së Fanarit në Stamboll, pati si kumbar Dhimitër Nolin, vëllain e peshkopit Fan Noli.

Prof. Kristo Frashëri ka një prodhimtari shkencore që mbulon një periudhë 70-vjeçare. Që nga viti 1938, ka botuar me dhjetëra e dhjetëra artikuj studimorë, referate historike, vëllime dokumentare dhe monografi shkencore, që trajtojnë ngjarje, personalitete dhe procese të historisë së Shqipërisë. Ndër to janë sprovat për të ndriçuar mjegullnajën shqiptare gjatë Mesjetës së hershme, rendin

feudal mesjetar në viset shqiptare, formacionet shtetërore mesjetare, tiparet e regjimit feudal turk në Shqipëri, jetën kulturore shqiptare gjatë shekujve të sundimit osman, Rilindjen Kombëtare Shqiptare, Luftën çlirimtare të Vlorës, zhvillimin e ekonomisë së tregut gjatë shekujve XIX-XX.

Spikatin punimet e botuara pas vitit 1990, si: “Lidhja e Prizrenit 1878-1881”; “Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe vepra” (2002); “Historia e Tiranës” (2004); “Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri” (2006); “Skënderbeu në burimet dokumentare shqiptare në shek. XV” (2005); “Identiteti kombëtar i shqiptarëve” (2006); “Historiografia shqiptare në tranzicion” (2006); “Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë” (2008); “Historia e qytetërimit shqiptar” 2008).